



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____.____.2024

PROCESVERBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR

(Mbledhje e realizuar me video konferencë)

(Mbajtur, më 09.05.2024)

Pika 1 e rendit të ditës me objekt: Shqyrtimi i projektvendimit “Për miratimin e strategjisë për uljen e numrit të çështjeve të prapambetura në gjykata”, për gatitur nga Grupi i Punës "Për hartimin e strategjisë për uljen e numrit të çështjeve të prapambetura në gjykata (anëtarët z. Ilir Rusi, z. Ridvan Hado dhe znj. Irena Plaku).

Drejton mbledhjen Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, zonja Naureda Llagami.

Mbledhja u zhvillua në sallën e mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 11:10 dhe mbaroi në orën 13:48.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

- 1. Naureda Llagami*** (kryetare)
- 2. Ilir Rusi*** (zëvendëskryetar)
- 3. Klodian Kurushi*** (anëtar)
- 4. Fatmira Luli*** (anëtare)
- 5. Irena Plaku*** (anëtare)
- 6. Gentiana Muçaj*** (anëtare)
- 7. Ridvan Hado*** (anëtar)
- 8. Alban Toro*** (anëtar)

9. *Markelian Koça* (anëtar)
10. *Yllka Rupa* (anëtare)
11. *Emona Muçi* (anëtare)

Morën pjesë gjithashtu nëpërmjet platformës dhe në sallë:

1. *Rudin Baqli, Sekretar i Përgjithshëm.*
2. *Blerta Ngucaj, Drejtore e Departamentit të Shërbimeve Juridike dhe Marrëdhënieve me Jasthë.*
3. *Luan Dibra, Rezarta Taushani, Gentiana Agushi, Këshilltarë pranë Komisioneve të Përhershme në Këshill.*
4. *Denisa Varfi dhe Entela Dobi përfaqësuese të Ministrisë së Drejtësisë.*
5. *Arturo Valdes dhe Arben Lila, përfaqësues të Projektit EU4Justice. (në sallë)*
6. *John Kostning dhe Sarmela Tiika, përfaqësues të Byrosë për Çështjet e Drogave dhe Zbatimit të Ligjit (Ambasada Amerikane). (në sallë)*
7. *Olta Lolo dhe Valbona Bala, përfaqësuese të EWMI/INL. (në sallë)*
8. *Sidorela Driçi, AIS Instituti Shqiptar i Shkencës (prezent në një pjesë të mbledhjes).*
9. *Staf nga administrata e KLGJ-së.*
10. *Përkthyes i gjuhës angleze, Enxhi Peçi.*

RENDI I DITËS:

1. Shqyrtimi i projektvendimit “Për miratimin e strategjisë për uljen e numrit të çështjeve të prapambetura në gjykata”, përgatitur nga Grupi i Punës "Për hartimin e strategjisë për uljen e numrit të çështjeve të prapambetura në gjykata (anëtarët z. Ilir Rusi, z. Ridvan Hado dhe znj. Irena Plaku).

Naureda Llagami: Po fillojmë mbledhjen e radhës, të Këshillit të Lartë Gjyqësor (KLGJ).

Në fakt, siç e kemi dhe lançuar bashkë, kjo është një mbledhje shumë e

rëndësishme. Është mbledhje e cila përkon në kuadrin e Ditës së Drejtësisë, Ditës së Evropës që kemi sot, dhe masat që Këshilli në fakt po merr për të adresuar një nga çështjet më problematike që ka sot sistemi, siç është backlog-u nëpër gjykata.

Ju e dini shumë mirë që Këshilli gjatë gjithë kësaj periudhe ka ndërmarrë disa masa të karakterit strategjik, masa të cilat me ndërhyrjen proaktive që ka bërë Këshilli, kanë pasur rezultate, por akoma nuk jemi aty ku ne shpresojmë që të jemi dhe ku qytetari shqiptar do të jetë.

Sot ne jemi shumë koshient që të gjithë sytë i kanë nga Këshilli i Lartë Gjyqësor, për shkak të backlog-ut. Kjo është një çështje që ne e kemi adresuar si një nga çështjet prioritare që ka pas ky Këshill.

Që në korrik të vitit të kaluar, KLGJ ka krijuar një grup pune ndërinstytucional, i cili është i përbërë nga gjyqtarë, nga kryetarë gjykatash, nga anëtarë gjyqtarë të Këshillit, dhe së bashku me partnerët tanë që i kemi çdo ditë këtu në Këshill dhe gjej rastin që i kemi edhe sot në mbledhje, t'i falënderoj për asistencën që i kanë dhënë Këshillit, kemi hartuar disa dokumente strategjike.

Këto dokumente në fakt janë dokumente të cilat në një farë mënyre kemi projektuar se ku duam të shkojmë dhe ku janë ndërhyrjet që Këshilli propozon për të luftuar dhe për të ulur numrin e backlog-ut. Pa diskutim që zbatimimi i të gjithë këtyre dokumenteve strategjike nuk mund të bëhet vetëm nga ana e KLGJ-së dhe për këtë duhet dhe mbështetje nga instrumente dhe nga segmentë të tjerë, siç është Kuvendi, siç është Ministria e Drejtësisë, që të adresohen dhe të zbatohen masat që propozohen sot dhe që ashtu sikurse ka vlerësuar grupi i punës dhe ekspertët tanë, pa diskutim që në një kohë të shkurtër do shkojë në uljen e numrit të çështjeve të prapambetura në gjykatë.

Ky është një hap shumë i rëndësishëm për KLGJ-në, nuk mund të themi që është perfekt por është një fillim shumë i mirë për të shkuar drejt qëllimeve dhe objektivave që kemi.

Unë në radhë të parë dëshiroj që të falënderoj Grupin e Punës, të cilët në një periudhë shumë mujore (le të themi) sepse e ka nisur punën që në korrik dhe deri tani kanë punuar intensivisht për të sjellë këtë lloj propozimi mbledhjes plenare. Është një

propozim i cili i është përcjellë edhe trupës gjyqësore, janë diskutuar edhe me trupën gjyqësore masat e propozuara dhe kemi pasur edhe mbështetje, por kemi pasur edhe kundërshti tek trupa gjyqësore, një pjesë e të cilave janë reflektuar dhe kemi ndryshuar, por për një pjesë janë akoma në proces reflektimi dhe konsultimi, por ajo që është më e rëndësishme është që ne si Këshill duhet të jemi të vetëdijshëm që këtë proces ne duhet ta fillojmë dhe të jemi të përgjegjshëm për ta çuar deri në fund, pasi përgjegjësia e të gjithë këtij procesi është përgjegjësia e KLGJ-së. Nëse ne duam që të shkojmë dhe të kemi një rezultat dhe të shkojmë pikërisht tek ai qëllim që kemi sot, për të cilën u bë edhe reforma, të përmirësojmë dhe të marri shërbim qytetari, patjetër që duhet të sforcohemi për të miratuar këto masa të cilat në radhë të parë tregojnë ndërgjegjshmërinë që ka Këshilli ndaj këtyre veprimeve, por nga ana tjetër do kërkojmë edhe mbështetjen jo vetëm nga partnerët tanë të cilët i kemi pasur në këtë proces, por edhe nga organe të tjera, siç është Kuvendi, për të cilën ne kemi propozuar ndryshime ligjore; sikurse është Ministria e Drejtësisë, për të cilën ne jemi në proces të vazhdueshëm për mbështetje infrastrukture dhe buxhetore.

Kështu që unë nuk dua të ndalem më gjatë.

Thjesht dëshiroj të falënderoj grupin e punës, të falënderoj Ilirin; të falënderoj Ridvanin; të falënderoj Irenën; të falënderoj të gjithë anëtarët e grupit të punës; të falënderoj të gjithë projektet që na kanë asistuar, duke filluar me Valbonën, me Oltën, me Arturin, me Arbenin, të gjithë kanë dhënë një kontribut shumë domethënës në këtë strategji.

Strategjia në fakt, unë dua dhe ta them edhe këtë, strategjia është një dokument i gjallë, që do të thotë që strategjia, neve jemi po këtu të gjithë bashkë, në momentin që ne shohim që kemi nevojë për ta përmirësuar, kemi nevojë për ta shtuar strategjinë, pa diskutim që Këshilli është këtu për të vepruar në funksion të nevojave që do ketë sistemi. Por e rëndësishme është që ne e kemi tashmë një vizion se ku duam të shkojmë dhe se çfarë masash ne duhet të marrim për të adresuar pjesën e backlog-ut. Këto masa në fakt janë masa konkrete, duhet ta themi këtë, janë masa reale, janë masa të bëra në një studim shumë të thellë statistikor, për aq sa ne kemi mundësi të prodhojmë statistika, por të

paktën dimë ku jemi dhe ku mund të shkojmë.

Kështu që, unë dëshiroj në cilësinë e Kryetares, por besoj edhe të anëtarëve të tjerë, të falënderoj grupin e punës dhe të gjithë ata që e kanë mbështetur atë; dhe t'ia jap fjalën për aktin e parë që ka të bëjë me miratimin e strategjisë, znj. Irena Plaku, e cila ka qenë anëtare e grupit të punës dhe do relatojë shkurtimisht aktin e parë.

Irena Plaku: Faleminderit!

Edhe unë në fakt dua të falënderoj edhe ekspertët ndërkombëtarë, z. Jesper dhe z. Pim, që na kanë bërë të mundur edhe analizimin e të dhënave statistikore, meqenëse të gjithë të tjerët u përmendën, prandaj doja të shtoja vetëm këto dy persona, për shkak se kanë bërë një analizë dhe kanë qenë pjesë e grupit të punës dhe takimeve që kemi bërë në çdo gjykatë, duke marrë edhe mendimet e gjyqtarëve të cilët kanë qenë pjesë e diskutimeve të shumta.

Ky material që ka të bëjë me strategjinë ka reflektuar të gjitha këto analiza dhe diskutime të zhvilluara në gjykata si dhe te grupi i punës.

Do ju parashtoj në vijim relacionin mbi projektin “Për miratimin e strategjisë për uljen e numrit të çështjeve të prapambetura...”.

Nevoja për hartimin e këtij vendimi vjen në zbatim të detyrimeve kushtetuese të përcaktuara në 147, pika 1 të Kushtetutës, që përcakton se, KLGJ-ja është përgjegjëse për mbarëvajtjen e pushtetit gjyqësor. Kompetenca kushtetuese e KLGJ-së për të siguruar mbarëvajtjen e pushtetit gjyqësor detajohet nga një sërë kompetencash ligjore, të parashikuara nënenet 89 dhe 94 të ligjit nr.115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë,” i ndryshuar, të cilat parashikojnë përgjegjësinë e KLGJ-së për monitorimin dhe menaxhimin e ngarkesës së gjyqtarëve dhe gjykatave, me qëllim përmirësimin e produktivitetit të gjykatave apo edhe detyrimin për miratimin e rregullave standarde për efikasitetin e gjykatave.

Akti që i paraqitet për miratim Këshillit është një akt nënligjor, i cili është i harmonizuar me misionin, vizionin dhe vlerat thelbësore të pushtetit gjyqësor, objektivat Strategjik 1 dhe 3 të Planit Strategjik të KLGJ-së 2022-2024. Strategjia përmbush

synimin për uljen e numrit të çështjeve të prapambetura në gjykata, dhe po ashtu krijon premisat për ofrimin e shërbimeve cilësore dhe në kohën e duhur. Gjithashtu, Strategjia për Uljen e Numrit të Çështjeve të Prapambetura është në përputhje edhe me objektivat strategjike të Strategjisë Ndërsektorale të Drejtësisë 2021 - 2025 të Ministrisë së Drejtësisë dhe e harmonizuar me prioritetet e politikave kombëtare, siç përshkruhen në Strategjinë Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim 2030 “Për krijimin e një sistemi drejtësie të pavarur, llogaridhënës dhe efikas në Shqipëri, i cili është në gjendje të japë drejtësi në mënyrë të drejtë dhe transparente”.

Standardet dhe parimet ndërkombëtarë që adresojnë efikasitetin e sistemeve gjyqësore, që kanë udhëhequr hartimin e kësaj strategjie janë të shumta, duke përfshirë edhe zhvillimet më novatore. Akti reflekton:

Parimet kryesore të miratuara nga CEPEJ, në studime dhe udhëzime që përcaktojnë masa që duhet të miratohen për të përmirësuar efikasitetin e sistemeve të drejtësisë;

Udhëzuesin e CEPEJ për uljen e backlog-ut, miratuar në vitin 2023;

Jurisprudencën e konsoliduar të Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut lidhur me të drejtën e parashikuar në nenin 6 KEDNJ për një gjykim të drejtë brenda një afati të arsyeshëm, në të kundërt vonesa mund të rrezikojë efektshmërinë dhe besueshmërinë e sistemit.

Strategjia për Uljen e Numrit të Çështjeve të Prapambetura, siç e theksova më lart, është produkt i punës intensive të Grupit të Punës, i krijuar në korrik të vitit 2023. Falë bashkëpunimit të ngushtë me kryetarët e gjykatave, Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, Gjykatës së Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, Gjykatës Administrative të Apelit Tiranë dhe partnerëve ndërkombëtarë dhe u dakordësua dhe u miratua nga ky grup pune në datën 29 mars 2024. Ky plan strategjie është në bashkëpunim edhe me ekspertët ndërkombëtarë që kanë qenë pjesë e grupit të punës, konkretisht: Instituti i Menaxhimit Lindje – Perëndim, Këshilli i Evropës dhe Projektin EU4Justice, të cilët kanë bashkëpunuar dhe pjesë e këtij projektstrategjie janë inkorporuar edhe mendimet e tyre.

Në bashkëpunim me ekspertët ndërkombëtarë që kanë mbështetur Grupin e Punës, në datat 25 – 28 mars, projektstrategjia është prezantuar përpara trupës gjyqësore të 4 gjykatave me backlog më të lartë, ndërsa në datën 29 mars u paraqit përpara anëtarëve të Këshillit dhe më pas u miratua nga Grupi i Punës.

Strategjia për Uljen e Numrit të Çështjeve të Prapambetura është pikënisja e një angazhimi afatgjatë të KLGJ-së dhe sistemit gjyqësor, por edhe i aktorëve të tjerë vendas dhe ndërkombëtarë për të arritur drejt ekselencës së gjykatave. Hartimi i këtij dokumenti strategjik është udhëhequr nga parimi se drejtësia duhet të ofrohet pa vonesa, në të kundërt ajo është drejtësi e mohuar. Për arritjen e këtij objekti nevojitet përmirësimi i vazhdueshëm i efikasitetit të gjykatave. KLGJ-ja miratoi dhe vuri në zbatim hartën e re gjyqësore përgjatë vitit 2023, duke synuar jo vetëm ekuilibrimin e ngarkesës nëpër gjykata, por mbi të gjitha për të unifikuar cilësinë e shërbimeve dhe drejtësisë së dhënë në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë.

Në vitin 2023, rreth 113.768 çështje u konsideruan në pritje për shqyrtim në gjykatat e shkallës së parë të juridiksionit të përgjithshëm dhe atij administrativ, Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm dhe Gjykatën Administrative të Apelit. Këto nivele alarmante të numrit të çështjeve të prapambetura rrezikojnë të kthehen në pengesën më serioze për aksesin në drejtësi dhe për uljen e besimit të publikut, i cili ka pasur gjithmonë vëmendjen kryesore nga KLGJ-ja. Prandaj, Grupi i Punës, i angazhuar maksimalisht për evidentimin e mekanizmave dhe masave praktike për uljen e çështjeve të prapambetura në gjykata dhe, po aq i angazhuar, edhe për parandalimin e tyre në të ardhmen, hartoi këtë draft strategji të paraqitur për miratim, me objektivin përfundimtar të funksionimit efikas dhe cilësor të sistemit të drejtësisë.

Grupi i punës përmbushi detyrat e mëposhtme sipas urdhrin për të cilin u krijua ky grup pune:

Vlerësoi dhe analizoi situatën në lidhje me numrin e çështjeve të prapambetura në gjykatat e shkallës së parë të juridiksionit të përgjithshëm, në gjykatën e apelit të juridiksionit të përgjithshëm, në gjykatat administrative të shkallës së parë dhe në Gjykatën Administrative të Apelit. Kjo analizë si sasiore ashtu edhe cilësore, përfshiu të

dhënat statistikore për periudhën 2013 – 2023. U morën në analizë indikatorët e efijencës (norma e likuidimit dhe kohëzgjatja e gjykimit të çështjeve). Gjithashtu u analizuan edhe burimet njerëzore në dispozicion, praktikat e menaxhimit aktiv të çështjeve, etj.

Statistikat e performancës së gjykatave fokusohen në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë dhe asaj të apelit, si gjykatat me numrin më të lartë të çështjeve të prapambetura. Statistikat e paraqitura kanë shërbyer si bazë për përshkrimin e prirjeve në lidhje me çështjet e ardhura, çështjet e gjykuara dhe çështjet e prapambetura. Gjithashtu gjykatat vlerësohen edhe për sa i përket Normës së Likuidimit të Çështjeve (NLCÇ) apo raporti midis çështjeve të zgjidhura dhe atyre të regjistruara rishtazi, që sipas rekomandimeve/standardeve minimale ndërkombëtare duhet të jetë në raportin 1:1 apo 100%. Duke parë këto shifra mund të krijohet një përshtypje e parë për efijencën e gjykatave, cilat janë zhvillimet në lidhje me ngarkesën dhe produktivitetin e tyre dhe sa të mëdha janë problematikat në fushën e çështjeve të vjetra në pritje për të gjykuar.

Identifikoi shkaqet bazë të grumbullimit të çështjeve të prapambetura

Vlerësoi kohëzgjatjen e procedurave gjyqësore dhe identifikoi standardet minimale kohore për gjykimin e kategorive të ndryshme të çështjeve.

Vlerësoi nevojën për përdorimin e kriterëve sasiore dhe identifikoi parashikime konkrete lidhur me normën e shqyrtimit të çështjeve për gjyqtar, sipas kategorive të çështjeve me qëllim përmirësimin e produktivitetit të gjykatave.

Vlerësoi numrin e nevojshëm të gjyqtarëve në Gjykatën Administrative të Apelit.

Vlerësoi numrin e nevojshëm të këshilltarëve ligjorë në gjykatat e shkallës së parë të juridiksionit të përgjithshëm dhe administrativ, Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm dhe Gjykatën Administrative të Apelit.

Pas vlerësimeve të mësipërme, Grupi i Punës hartoi dhe miratoi një plan masash konkrete afatshkurtra dhe masa strategjike, të cilat targetojnë problematika konkrete që lidhen me gjyqtarët, gjykatat dhe sistemin gjyqësor. Strategjia përcakton përmasat e problemeve në gjykata, të cilat shkaktojnë volumnin e madh të çështjeve të prapambetura,

ofron një perspektivë për sa i përket skenarëve për pakësimin e tyre në tri vitet e ardhshme, si dhe prezanton masa praktike për uljen e çështjeve të prapambetura dhe parandalimin e tyre në të ardhmen, duke ofruar, gjithashtu, një sërë masash ligjore të nevojshme për uljen e çështjeve të prapambetura dhe përmirësimin e efikasitetit të drejtësisë në gjykatat shqiptare. Po ashtu këto masa adresojnë nevojën për më shumë burime njerëzore, përmirësime infrastrukturore në gjykata, nevojën për ndërveprim më të ngushtë me aktorë të tjerë të sistemit të drejtësisë, por edhe me dy pushtetet e tjera, dixhitalizimin e shërbimeve, trajnimin dhe edukimin e vazhdueshëm të nëpunësve civilë gjyqësorë.

Gjatë veprimtarisë së tij, Grupi i punës i ka përcjellë Kuvendit të Republikës së Shqipërisë dhe Ministrisë së Drejtësisë, një set propozimesh për ndryshime ligjore, të cilat janë në kuadër të rritjes së efikasitetit në sistemin e drejtësisë, konkretisht janë propozuar:

Ndryshime në Kodin e Procedurës Civile, që vijnë si rezultat i evidentimit të nevojave për të përmirësuar shpejtësinë e gjykimit të disa kategori të caktuara e të kufizuara të çështjeve civile (të cilat në fakt përbënin edhe numrin më të madh të çështjeve të cilat ishin të regjistruara dhe që ishin backlog në gjykatën e shkallës së parë, konkretisht me urdhrat e ekzekutimit). Nëpërmjet këtyre rregullimeve të reja procedurale synohet krijimi i kushteve që do të ndihmojnë në një ulje të mbingarkesës së gjykatave të apeleve dhe shqyrtimin e çështjeve të këtyre kategorive, por edhe të të gjitha gjykimeve në tërësi, në kohë më të shpejtë në drejtim të objektivit dhe detyrimit ligjor për shqyrtimin e çështjeve brenda afateve të arsyeshme.

Gjithashtu është propozuar ndryshim në ligjin “Për gjykatat administrative”, të cilat vijnë si nevojë për të përmirësuar shpejtësinë e gjykimit të disa kategorive të caktuara të çështjeve administrative, njëkohësisht duke lehtësuar procedurat për gjykimin e tyre, si edhe ngarkesën e punës së trupave gjyqësore dhe të gjyqtarëve të Gjykatës Administrative të Apelit.

Në ligjin “Për organizimin e pushtetit gjyqësor”, të cilat vijnë si rezultat i evidentimit të nevojave për të përmirësuar organizimin dhe funksionimin e gjykatave,

veçanërisht në drejtim të krijimit të mundësive për të rritur burimet njerëzore, si edhe për të krijuar kushtet që vetë gjykatat dhe Këshilli i Lartë Gjyqësor të vlerësojnë, sipas rrethanave të veçanta dhe ecurisë së shqyrtimit gjyqësor të çështjeve, ushtrimin e kompetencave vendimmarrëse që i shërbejnë rritjes së efektivitetit, produktivitetit, shpejtësisë dhe cilësisë së gjykimit. Për të rritur efikasitetin e dhënies së drejtësisë në gjykata, duhet të rritet jo vetëm numri i gjyqtarëve, por edhe i ndihmësve ligjorë apo stafit tjetër mbështetës jogjyqtar. Për të përforcuar delegimin e punës administrative nga gjyqtarët te stafi mbështetës, referuar edhe standardeve ndërkombëtare nevojitet të ketë staf të mjaftueshëm (ndihmës ligjorë dhe sekretarë gjyqësorë/ staf tjetër mbështetës jogjyqtar) në dispozicion për të ndihmuar gjyqtarët.

Ndryshimet ligjore të propozuara synojnë rritjen e numrit të ndihmësve ligjorë deri në dy ndihmës ligjorë për gjyqtar në gjykatat e shkallës së parë dhe apelit, rritjen e trajtimit të tyre financiar si një mjet nxitës për përzgjedhjen e kësaj karriere nga ana e profesionistëve të së drejtës dhe lehtësimin e procedurave të rekrutimit të tyre duke parashikuar të njëjtën procedurë sikurse edhe rekrutimi i nëpunësve të tjerë civilë gjyqësorë nga gjykatat.

Ndryshime në ligjin nr. nr.115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”. Edhe këto ndryshime vijnë në kuadër të ndryshimeve për sa i përket ndihmësve ligjorë.

Gjithashtu janë propozuar ndryshime në Kodin e Procedurës Penale të Republikës së Shqipërisë, që synojnë të ndikojnë pozitivisht në lehtësimin e gjendjes së vonesave në gjykime dhe në mbingarkesën e gjyqtarëve. Qëllimi i ndryshimeve është rritja e efikasitetit dhe efektshmërisë në sistemin e drejtësisë në tërësi dhe atë gjyqësor në veçanti, nëpërmjet rregullimeve procedurale për rritjen e numrit të çështjeve penale që mund të shqyrtohen dhe vendosen në gjykatën e apelit me një gjyqtar, pra jo me trupë kolegjiale të përbërë prej 3 gjyqtarësh, referuar kjo edhe praktikave të mëparshme të ndryshimeve ligjore, duke mundësuar për këto kategori të kufizuar çështjesh zhvillimin e proceseve gjyqësore më efikase dhe në kohë më të shkurtër.

Projektstrategjia krijon edhe një mekanizëm monitorimi të vazhdueshëm, për të

ndjekur përmbushjen e objektivave.

Qëllimi final i kësaj strategjie është parandalimi i krijimit të backlog-ut në të ardhmen dhe ulja e numrit të çështjeve të prapambetura, prandaj ajo përcakton orientime për të pasur një performancë efektive të sistemit gjyqësor, duke u bazuar në mësimet e nxjerra nga praktikat e mira vendase për uljen e backlog-ut.

Strategjia është strukturuar si më poshtë:

- Pjesa e parë përshkruan situatën aktuale të gjykatave duke analizuar prirjet në çështjet e reja të ardhura në gjykatë, ato të gjykuara si dhe volumin aktual të çështjeve të prapambetura. Aty detajohet situata aktuale e burimeve njerëzore në gjykata (gjyqtarë dhe personel mbështetës) dhe ofrohet perspektiva për plotësimin e vendeve vakante në 3 vitet e ardhshme.

- Pjesa e dytë paraqet synimet dhe objektivat e kësaj strategjie si dhe përshkruan masat kryesore për uljen e numrit të çështjeve të prapambetura dhe parandalimin e tyre.

- Pjesa e tretë diskuton skenarët e mundshëm për uljen e numrit të çështjeve të prapambetura sipas zbatimit të objektivave të strategjisë.

- Pjesa e katërt ofron rekomandime për zbatimin e një strategjie kombëtare për uljen e numrit të çështjeve të prapambetura në gjykata.

- Shtojcat: Plan Veprimi i detajuar për zbatimin e strategjisë në gjykata, të cilat do të zbatohen më pas dhe do të monitorohen nga gjykatat dhe nga KLGJ-ja.

Misioni i strategjisë- Gjykatat e shkallës së parë dhe të apelit në Shqipëri janë të përkushtuara të japin drejtësi në një mënyrë të shpejtë dhe efikase, në përputhje me legjislacionin shqiptar dhe parimet evropiane, duke i dhënë përparësi promovimit të standardeve të larta të efektivitetit dhe cilësisë së gjykimit.

Vizioni është që gjykatat e shkallës së parë dhe të apelit në Shqipëri të arrijnë ekselencën duke u karakterizuar nga një ulje e numrit të çështjeve të prapambetura në një nivel normal e të pranueshëm, nga vonesa minimale në proceset gjyqësore si dhe nga dhënia e shpejtë e me cilësi e drejtësisë, si e vetmja rrugë për garantimin dhe respektimin e të drejtave dhe lirive themelore të qytetarëve shqiptarë.

Synimet strategjike për uljen e numrit të çështjeve të prapambetura -

Synimet janë që në periudhën 2024 – 2027, për gjykatat e shkallës së parë të juridiksionit të përgjithshëm dhe administrativ Tiranë dhe gjykatat e apelit, juridiksioni i përgjithshëm dhe administrativ përcaktohen këto synime, konkretisht:

1. Në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë dhe Administrativ, të gjitha çështjet në pritje mund të zgjidhen përgjatë periudhës 2025/2026 nëse rritet produktiviteti i gjyqtarëve, ndërsa volumi i çështjeve të ardhura nuk rritet në mënyrë të ndjeshme.

2. Në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm, volumi i çështjeve të prapambetura do të ulet me 20 – 30% (pakësim me 10.000 deri në 15.000 çështje).

3. Në Gjykatën Administrative të Apelit, volumi i çështjeve të prapambetura do të ulet me 25% (pakësim i prapambetjes me 5000 çështje).

Strategjia kombëtare për uljen e numrit të çështjeve të prapambetura është në përputhje me planin strategjik të KLGJ-së dhe detajon synimet e mëposhtme të Planit Strategjik të KLGJ-së:

Synimi 1: Përsheptimi i zbatimit të reformës së pushtetit gjyqësor dhe akordimit të burimeve.

Synimi 2: Zbatimi dhe monitorimi i standardeve për ekselencë gjyqësore.

Synime 3: Ofrimi efikas i shërbimeve dhe funksionimi më i mirë i gjykatave.

Synimi 4: Fuqizimi i kapaciteteve të brendshme të KLGJ-së.

Synimi 5: Zbatimi dhe përmirësimi i strategjive për komunikimin e jashtëm.

Për të realizuar synimet dhe objektivat e strategjisë së KLGJ-së për uljen e numrit të çështjeve të prapambetura, janë përcaktuar objektivat strategjike si më poshtë, konkretisht:

1. Ulja strukturore e çështjeve të prapambetura në gjykatat e shkallës së parë të juridiksionit të përgjithshëm dhe administrativ Tiranë, në Gjykatën e Apelit Administrativ dhe në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm për periudhën 2024 – 2027 nëpërmjet marrjes së masave konkrete për uljen e çështjeve të prapambetura.

1.1 Krijimi i një inventari të çështjeve të prapambetura në gjykata.

1.2 Krijimi i ekipeve për uljen e numrit të çështjeve të prapambetura.

1.3 Përfshirja e masave të menaxhimit aktiv të çështjeve (si menaxhimi i diferencuar i çështjeve, filtrimi dhe grupimi i çështjeve).

1.4 Miratimi i planeve individuale për veprim nga ana e gjykatave, pasi në strategji në fakt është parashikuar që edhe vetë gjykatat mund të marrin masa edhe më efikase, më vete, për uljen e ngarkesës në gjykata.

2. Fuqizimi i kapaciteteve në gjykata me marrjen e masave për emërimin dhe përsheptimin e ngritjes në detyrë të gjyqtarëve, heqjen e pengesave për përzgjedhjen, trajnimin dhe emërimin e ndihmësve ligjorë në gjykata dhe rritjen në përgjithësi të numrit të stafit mbështetës jogjyqtar.

2.1 Plotësimi i vakancave nëpërmjet rekrutimit/emërimit, lëvizjes paralele dhe ngritjes në detyrë të gjyqtarëve.

2.2 Rritja e numrit të gjyqtarëve të Gjykatës Administrative të Apelit.

2.3 Rritja e numrit dhe thjeshtimi i procesit të punësimit të ndihmësve ligjorë/stafit mbështetës.

2.4 Forcimi i kapaciteteve nëpërmjet trajnimit të ndihmësve ligjorë/stafit tjetër mbështetës jogjyqtar.

3. Përmirësimi i metodave dhe proceseve të punës. Konkretisht masat janë:

3.1 Delegimi i detyrave të caktuara në lidhje me çështje të thjeshta nga një gjyqtar te stafi mbështetës i gjykatës (në fakt këto masa janë zbatuar në Gjykatën e Juridiksionit të Përgjithshëm të Shkallës së Parë Tiranë).

3.2 Nxitja e shkëmbimit të versioneve elektronike të dokumenteve gjyqësore si vendimeve gjyqësore ndërmjet gjykatave apo aktorëve të tjerë në proces.

3.3 Zhvillimi i seancave gjyqësore në distancë.

3.4 Përdorimi i modeleve standarde për vendimet gjyqësore/urdhrat e gjykatës e dokumente të tjera.

3.5 Zgjedhje më efektive e trupave gjykues të gjykatave të apelit.

Objektivi 4. Prezantimi i një pakete ndryshimesh ligjore të përqendruara në uljen e çështjeve të prapambetura dhe zbatimin e masave konkrete për parandalimin e çështjeve të prapambetura në gjykata për të shmangur rritjen e tyre në të ardhmen. Në këtë

propozim janë marrë këto masa:

4.1 Promovimi i një gjyqtari të vetëm në gjykatë.

4.2 Kufizimi i mundësisë së ankimit për një lloj çështjeje të caktuar në fushën e së drejtës civile dhe administrative.

4.3 Ndryshime ligjore në sistemin për lëshimit të urdhrave të ekzekutimit.

Objektivi 5: Përcaktimi i standardeve minimale kohore dhe sasiore dhe matja e performancës së gjyqtarëve. Në këtë objektivi kanë qenë:

5.1 Përcaktimi i standardeve minimale kohore dhe sasiore për gjyqtarët.

5.2 Matja e performancës së ndihmësve ligjorë.

5.3 Përmirësimi i metodave të mbajtjes së statistikave gjyqësore sipas llojeve të veçanta të çështjeve.

Objektivi 6: Rritja e bashkëpunimit dhe koordinimit ndërinstitucional me aktorë të tjerë. Konkretisht është:

6.1 Lidhja e marrëveshjeve të bashkëpunimit me bashkëpunëtorët e gjykatave.

6.2 Zhvillimi i takimeve periodike.

Një ndër objektivat tepër të rëndësishëm është edhe 7. Rritja e transparencës dhe e besimit të publikut. Masat që propozohen janë:

7.1 Informimi i publikut mbi masat e ndërmarra.

7.2 Publikimi i rezultateve për uljen e çështjeve të prapambetura.

Në lidhje me zbatimin e aktit:

Suksesi i kësaj strategjie varet thelbësisht nga bashkëpunimi dhe qasja proaktive e gjykatave, por edhe aktorëve të tjerë. Udhëheqja efektive është thelbësore për fillimin e ndryshimeve, përmirësimin e performancës në gjykata, për zhvillimin e një vizioni të ardhshëm për gjyqësorin dhe për të inkurajuar gjyqtarët dhe stafin për të ecur përpara. Faktori i dytë kritik është mbështetja institucionale vendase dhe ajo e partnerëve ndërkombëtarë. Duke qenë se zbatimi i disa masave sjell ndikim në buxhetin e shtetit dhe kërkon ndërhyrje të menjëhershme për miratimin e paketës së ndryshimeve ligjore, Këshilli i Lartë Gjyqësor ka nevojë për mbështetjen institucionale me prioritet të Kuvendit, Ministrisë së Drejtësisë, Ministrisë së Financave. Në zbatim të prioriteteve dhe

parashikimeve në përmbushjen e vakancave Këshilli ka nevojë në mbështetjen institucionale të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, institucioneve të rivlerësimit kalimtar apo institucioneve të tjera roli i të cilave është vendimtar në procesin e promovimit të gjyqtarëve. Bashkëbisedimi me aktorë të tjerë në proces dhe profesionistët e së drejtës ka gjithashtu një rol kyç. Bashkëpunimi me partnerët ndërkombëtarë, është gjithashtu thelbësor në mënyrë të tillë që nisma të suksesshme në uljen e çështjeve të prapambetura si ajo e zbatuar në Gjykatën e Lartë të zbatohen edhe në gjykata të tjera veçanërisht në ato të apelit.

Faktori i fundit dhe i tretë kritik për një zbatim të suksesshëm të strategjisë kombëtare për uljen e çështjeve të prapambetura, ka të bëjë me nevojën për të investuar në përmirësimin e matjes së performancës së gjykatave dhe statistikave të fokusuara në çështjet e prapambetura sipas treguesve të CEPEJ-it. Studimi i ngarkesës së gjyqtarëve sipas llojit të veçantë të çështjeve apo aplikimi i metodave të peshimit të çështjeve në matjen e performancës gjyqësore do të sillte përmirësime të dukshme në alokimin e burimeve të nevojshme gjyqësore dhe mbështetëse.

Është e domosdoshme që procesi i uljes së çështjeve të prapambetura të monitorohet vazhdimisht në mënyrë periodike nga vetë gjykatat dhe Këshilli i Lartë Gjyqësor nëpërmjet hartimit të raporteve për ecurinë e uljes së çështjeve të prapambetura, bazuar në modelin e miratuar nga Këshilli i Lartë Gjyqësor. Këto raporte do të ofrojnë një pasqyrë më të mirë në ecurinë e uljes së çështjeve të prapambetura në gjykata, nëse gjykatat janë në gjendje të arrijnë objektivat strategjike të përcaktuara nga Këshilli i Lartë Gjyqësor. Është gjithashtu e rëndësishme që Këshilli të mund të reagojë në kohë të shpejtë në raste kur këto objektiva rrezikojnë të mos realizohen.

Sa i përket efekteve financiare, strategjia nuk krijon efekte financiare shtesë për vitin 2024, megjithatë KLGJ mbetet e angazhuar për të përfshirë në proceset e rishikimi të buxhetit të sistemit të drejtësisë aktivitetit konkrete, për të siguruar mbështetjen e duhur financiare për përmbushjen e objektivave dhe veprimeve konkrete. Strategjia synon të vihet në zbatim edhe nëpërmjet mbështetjes financiare të partnerëve ndërkombëtarë, të cilët do të ofrojnë edhe ekspertizën për të krijuar një praktikë të

konsoliduar të zbatimit të saj.

Faleminderit!

Me strategjinë në fakt jeni njohur të gjithë.

Naureda Llagami: Shumë faleminderit Irena për relatimin e masave që përmban strategjia.

Po zoti Toro!

Alban Toro: Në fakt në çdo kushte pasigurie kërkohet një plan veprimi i cili ndihmon realizimin e qëllimeve afatgjata dhe jo më kot, siç duket grupi i punës e ka konsideruar strategji, nga vetë fjala greke që do të thotë “arti i udhëheqjes”. Pra dy janë komponentët e strategjisë... Ta përsëris edhe një herë?

Pra me të drejtë grupi i punës ka përcaktuar këtë dokument thelbësor si strategji pasi strategjia vjen nga fjala greke që do të thotë “arti i udhëheqjes” dhe përfaqëson një plan të përgjithshëm për të arritur një apo shumë qëllime afatgjata ose të përgjithshme në kushte pasigurie. Pra dy janë komponentët e strategjisë: i) qëllimi i dëshirueshëm dhe ii) mjetet e disponueshme.

Më vjen keq se konstatoj një gjuhë të moderuar dhe diplomatike kur vjen fjala për raportin me institucionet e tjera të cilat do duhet të ndihmonin Këshillin e Lartë Gjyqësor në përmbushjen e detyrimeve të veta, atë të përmirësimit të sistemit gjyqësor. Dhe unë në këtë kontekst do të dëshiroja të përfshija një fjali e cila do ta zhveshë nga gjuha diplomatike, pra pas paragrafit “Duke qenë se zbatimi i disa masave sjell ndikim në buxhetin e shtetit dhe kërkon ndërhyrje të menjëhershme për miratimin e paketave të ndryshimeve ligjore, Këshilli i Lartë Gjyqësor ka nevojë për mbështetjen institucionale me prioritet të Kuvendit, Ministrisë së Drejtësisë, Ministrisë së Financave”, pas kësaj fjale, unë e konstatoj dhe dëshiroj që të përfshihet "Pa këtë mbështetje, ky dokument do të mbetet fiktiv dhe pa vlerë."

Arsyet pse e them këtë është shumë e thjeshtë. Gjithmonë, që në momentin e krijimit, fjala e KLGJ-së për publikun ka qenë një punë e vazhdueshme për të

përmirësuar sistemin gjyqësor, tashmë i ndodhur në gjendje kolapsi dhe emergjence, dhe kemi arritur të krijojmë një standard minimal, të paktën për të realizuar dhe për të siguruar aksesin e tyre në sistemin e drejtësisë. Ndërkohë që, puna e institucioneve të cilat në bazë të Kushtetutës do duhet të suportonin KLGJ-në, ka qenë vetëm fjala. Dhe këtu rastet i kemi të shumta, ku minimalisht fondet e ngrira në buxhet, mungesa e fondeve për të përmirësuar infrastrukturën gjyqësore, të cilat tashmë kanë ngelur në ngrehina gjyqësore (nuk mund të inventarizohen as si monument kulture, sepse s'vlejnë edhe për të tilla) dhe mungesa e trojeve, të cilat janë bërë një plagë e vazhdueshme, ku ne miratojmë fonde për projekte por fondet digjen sepse mungojnë trojet, pra një mungesë e theksuar bashkëpunimi me këto institucione të cilat teorikisht do duhet të ishin përfshirë, në një gjuhë të paktën s'po them të ashpër, por me gjuhën e bashkëpunimit konkret me të cilën kemi me këto institucione, me Ministrinë e Financave, bashki apo qoftë edhe parlament, sepse në fund të fundit të gjithë këto akte të kryera nga këto institucione nuk ndihmojnë në përmirësimin e sistemit të drejtësisë dhe aktualisht ne do përpilojmë një letër, do krijojmë ca realitete fiktive në këtë strategji apo iluzione të përmirësimit të së ardhshmes, por që në fund përsëri do të shkojmë tek bashkëbisedimi i Hamletit me Polonin "Fjalë imzot, fjalë". Nuk ndihmojmë dhe as nuk rregullojmë këtë sistem drejtësie duke mos vënë pikat mbi "i". Dhe unë shoh që pa këtë bashkëpunim, bashkëpunim konkret, i cili do duhet të jetë përtej fjalës, i realizuar me vepra, që do të thotë, larg tentativave për të bllokuar fondet e KLGJ-së; bashkëpunim i menjëhershëm për të vendosur fonde për blerje fondesh apo riparimin e infrastrukturës gjyqësore, të paktën të krijojmë një minimum standard që t'i përngjajnë gjykatave, qoftë edhe të Ballkanit. Sidomos për Tiranën, gjendja është alarmante. Nuk bëhet fjalë për gjykata. Ashtu siç e thashë më parë bëhet fjalë për ngrehina gjyqësore, fosile inxhinierike të së kaluarës, që nuk ofrojnë asnjë lloj serioziteti për punën jo vetëm që kryhet nga trupa gjyqësore atje por edhe vetë publiku ka konstatuar që kjo infrastrukturë lë për të dëshiruar dhe më tej pastaj të kërkojmë që të përmirësojmë sistemin gjyqësor me këtë lloj bashkëpunimi. Kështu që unë do të sugjeroja që pas kësaj fjalie, pra pas "Ministrisë së Financave", të shtohet edhe fjalia apo togfjalëshi "Pa këtë mbështetje, ky dokument do të mbesë fiktiv

dhe pa vlerë."

Naureda Llagami: Shumë faleminderit z. Toro.

Në fakt edhe unë jam dakord me z. Toro. Këtë gjë ne do vazhdojmë ta bëjmë edhe në eventin që do bëjmë lançimin e kësaj strategjie, ku thelbi i kësaj strategjie është që Këshilli po s'pati mbështetje, nuk mund të realizojë dot asnjë nga gjërat që mund të marri angazhim. Me kapacitetet që kemi, kemi bërë shumë, por nëse ne nuk kemi mbështetje, nëse kjo mbështetje nuk është e koordinuar nga të gjithë institucionet (pa dashur që të përsëris zotin Toro), ne nuk mundemi dot të bëjmë asgjë më shumë. Kështu që do i propozoja në fakt grupit të punës, në qoftë se kanë mirëkuptimin, që ta shtojnë edhe këtë pjesë, për të treguar ndoshta tonet e faktit që kjo është tashmë një çështje kombëtare, nuk është vetëm përgjegjësia e Këshillit të Lartë Gjyqësor - Këshilli i Lartë Gjyqësor gjatë gjithë këtij procesi ka marrë masat dhe ka ndërhyrë – kjo është përtej nesh dhe prandaj kërkojmë sensibilizimin dhe vëmendjen e të gjithë institucioneve të tjera.

Jemi dakord me propozimin?

Ilir Rusi: Dakord.

Irena Plaku: Unë në fakt jam dakord. Dua të them që ky është një angazhim i të gjithë institucioneve, domethënë i gjykatave, i Këshillit të Lartë Gjyqësor, domethënë të gjithë në këtë situatë duhet të marrim masat tona, aq sa e kemi të mundur për të zbatuar këtë strategji, të cilën është e nevojshme dhe tepër e domosdoshme dhe mbështetja financiare në vijim.

Gentiana Muçaj: Dakord.

Ridvan Hado: Dakord.

Alban Toro: Dakord.

Fatmira Luli: Dakord.

Markelian Koça: Dakord.

Yllka Rupa: Pro.

Emona Muçi: Dakord.

Klodian Kurushi: Dakord me propozimin.

Naureda Llagami: Dakord.

Naureda Llagami: Atëherë, kalojmë në miratim të tërësi strategjinë me të gjithë ndryshimin e miratuar?

Illir Rusi: Dakord.

Irena Plaku: Pro.

Gentiana Muçaj: Dakord.

Ridvan Hado: Dakord.

Alban Toro: Dakord.

Fatmira Luli: Dakord.

Markelian Koça: Dakord.

Yllka Rupa: Pro.

Emona Muçi: Dakord.

Klodian Kurushi: Dakord.

Naureda Llagami: Dakord.

Atëherë Këshilli vendosi:

1.Miratimin e strategjisë për uljen e numrit të çështjeve të prapambetura në gjykata, sipas tekstit bashkëlidhur këtij vendimi dhe pjesë përbërëse e tij.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

* * *

(Pika 1 e rendit të ditës)

Për Këshillin e Lartë Gjyqësor



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____.____.2024

PROCESVERBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR

(Mbledhje e realizuar me video konferencë)

(Mbajtur, më 09.05.2024)

Pika 2 e rendit të ditës me objekt: Shqyrtimi i projektvendimit “Për miratimin e raportit vlerësues të Grupit të Punës për hartimin e strategjisë për uljen e numrit të çështjeve të prapambetura në gjykata për rritjen e numrit të përgjithshëm të gjyqtarëve në Republikën e Shqipërisë”, përgatitur nga Grupi i Punës "Për hartimin e strategjisë për uljen e numrit të çështjeve të prapambetura në gjykata (anëtarët z. Ilir Rusi, z. Ridvan Hado dhe znj. Irena Plaku).

Drejton mbledhjen Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, zonja Naureda Llagami.

Mbledhja u zhvillua në sallën e mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 11:10 dhe mbaroi në orën 13:48.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

- 1. Naureda Llagami*** (kryetare)
- 2. Ilir Rusi*** (zëvendëskryetar)
- 3. Klodian Kurushi*** (anëtar)
- 4. Fatmira Luli*** (anëtare)
- 5. Irena Plaku*** (anëtare)
- 6. Gentiana Muçaj*** (anëtare)

7. *Ridvan Hado* (anëtar)
8. *Alban Toro* (anëtar)
9. *Markelian Koça* (anëtar)
10. *Yllka Rupa* (anëtare)
11. *Emona Muçi* (anëtare)

Morën pjesë gjithashtu nëpërmjet platformës dhe në sallë:

1. *Rudin Baqli, Sekretar i Përgjithshëm.*
2. *Blerta Ngucaj, Drejtore e Departamentit të Shërbimeve Juridike dhe Marrëdhënieve me Jashtë.*
3. *Luan Dibra, Rezarta Taushani, Gentiana Agushi, Këshilltarë pranë Komisioneve të Përhershme në Këshill.*
4. *Denisa Varfi dhe Entela Dobi, përfaqësuese të Ministrisë së Drejtësisë.*
5. *Arturo Valdes dhe Arben Lila, përfaqësues të Projektit EU4Justice. (në sallë)*
6. *Olta Lolo dhe Valbona Bala, përfaqësuese të EWMI/INL. (në sallë)*
7. *Sidorela Driçi, AIS Instituti Shqiptar i Shkencës (prezent në një pjesë të mbledhjes).*
8. *Staf nga administrata e KLGJ-së.*

RENDI I DITËS:

2. Shqyrtimi i projektvendimit “Për miratimin e raportit vlerësues të Grupit të Punës për hartimin e strategjisë për uljen e numrit të çështjeve të prapambetura në gjykata për rritjen e numrit të përgjithshëm të gjyqtarëve në Republikën e Shqipërisë”, përgatitur nga Grupi i Punës "Për hartimin e strategjisë për uljen e numrit të çështjeve të prapambetura në gjykata (anëtarët z. Ilir Rusi, z. Ridvan Hado dhe znj. Irena Plaku).

Naureda Llagami: Kalojmë në projekt-aktin tjetër, i cili edhe ky projekt-akt nuk është më pak i rëndësishëm. Ka të bëjë me shqyrtimin “Për miratimin e raportit vlerësues të Grupit të Punës për hartimin e strategjisë për uljen e numrit të çështjeve të

prapambetura në gjykata për rritjen e numrit të përgjithshëm të gjyqtarëve në Republikën e Shqipërisë”.

Ky është një vlerësim tjetër që propozohet nga grupi i punës dhe do të relatohet nga zoti Hado.

Ridvan Hado: Faleminderit!

Pa u ndalur në falënderimet për ndihmesën e dhënë, mos të biem në përsëritje, i thatë ju dhe zonja Plaku. Po kaloj direkt në relativim.

Pas miratimit të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 495, datë 21.07.2022, “Për riorganizimin e rretheve gjyqësore dhe kompetencave tokësore të gjykatave”, Këshilli i Lartë Gjyqësor ka miratuar me vendimin nr. 553, datë 29.12.2022 “Për caktimin e numrit të gjyqtarëve në gjykatën e apelit të juridiksionit të përgjithshëm”, vendimin nr. 146, datë 29.03.2023 “Për caktimin e numrit të gjyqtarëve në gjykatat e shkallës së parë të juridiksionit të përgjithshëm” dhe vendimin nr. 286, datë 29.05.2023, “Për caktimin e numrit të gjyqtarëve në gjykatat administrative të shkallës së parë”. Në këto vendime Këshilli ka parashikuar se, numri i gjyqtarëve të Gjykatës së Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm është 78, numri i gjyqtarëve në gjykatat e shkallëve të para të juridiksionit të përgjithshëm është 235 gjyqtarë dhe numri i gjyqtarëve të gjykatave administrative të shkallës së parë është 36. Numri i gjyqtarëve në Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë për gjykimin e veprave penale të korrupsionit dhe krimit të organizuar është 16 gjyqtarë dhe numri i gjyqtarëve në Gjykatën e Posaçme të Apelit për gjykimin e veprave penale të korrupsionit dhe krimit të organizuar është 11 gjyqtarë. Numri i gjyqtarëve në Gjykatën Administrative të Apelit është 13 gjyqtarë, sipas Dekretit të Presidentit të Republikës nr. 7818, datë 16.11.2012 “Për caktimin e numrit të gjyqtarëve për çdo gjykatë të shkallës së parë, të apelit dhe të gjykatave administrative, si dhe caktimin e kompetencave tokësore dhe selisë qendrore të gjykatave administrative”, i ndryshuar. Totali i numrit të përgjithshëm të gjyqtarëve në Republikën e Shqipërisë i përcaktuar me dekretin e mësipërm është aktualisht prej 408 gjyqtarësh, e ndarë në këtë mënyrë:

Gjykata e Lartë – 19 gjyqtarë në organikë; Gjykata e Apelit të Juridiksionit të

Përgjithshëm – 78 gjyqtarë; Gjykata Administrative e Apelit – 13 gjyqtarë; Gjykata e Posaçme e Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar – 11 gjyqtarë; Gjykatat e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm – 235 gjyqtarë; Gjykatat Administrative të Shkallës së Parë – 36 gjyqtarë; Gjykata e Posaçme e Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar – 16 gjyqtarë; duke qenë gjithsej 408 gjyqtarë në sistem.

Këshilli ka detyrimin për përcaktimin e numrit të gjyqtarëve. Ky detyrim buron nga neni 22 i ligjit 98/2016 i ndryshuar, “Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë”, në të cilin parashikohet se:

1. Këshilli i Lartë Gjyqësor mbikëqyr vazhdimisht ngarkesën e çështjeve gjyqësore dhe të punës së gjykatave, duke u bazuar në të dhënat e mbledhura, me qëllim përmirësimin e efijencës së gjykatave ose zvogëlimin e ngarkesës së punës së gjyqtarëve dhe personelit të gjykatës.

2. Këshilli i Lartë Gjyqësor përgatit dhe publikon brenda muajit qershor të çdo viti raportin vjetor për ngarkesën e çështjeve gjyqësore dhe të punës së gjykatave për vitin kalendarik të mëparshëm, duke përfshirë rekomandime për përmirësimin e efijencës së gjykatave ose për zvogëlimin e ngarkesës së punës së gjyqtarëve dhe personelit të gjykatës.

3. Të paktën çdo pesë vjet Këshilli i Lartë Gjyqësor vlerëson numrin e gjyqtarëve për çdo gjykatë dhe nëse është e nevojshme rishikon numrin e gjyqtarëve pas marrjes së mendimit nga Këshilli i Gjykatës.

4. Procesi i përcaktimit të numrit të gjyqtarëve për çdo gjykatë mbështetet në objektivat e parashikuar në nenin 14, të këtij ligji, me qëllim sigurimin e ngarkesës së ekuilibruar të punës së gjithë gjyqtarëve në Shqipëri. Procesi kryhet në mënyrë transparente, duke u bazuar në analizën e raporteve vjetore dhe efijencës së masave të marra për zbatimin e rekomandimeve të përcaktuara në raportet vjetore, sipas pikës 2 të këtij neni.

Nisur nga ky detyrim ligjor, Këshilli vlerësoi se rishikimi i numrit të gjyqtarëve për çdo gjykatë, ishte proces që lidhej pazgjidhshmërisht me procesin e riorganizimit e rishikimit të madhësisë së gjykatave (Harta Gjyqësore), sepse të dy proceset kërkonin

analizë disavjeçare të ngarkesës së gjykatave ndaj edhe miratoi ndryshimet përkatëse në numrin e gjyqtarëve në gjykatat e prekura nga riorganizimi.

Pjesë e analizës që çoi në propozimin e hartës së re gjyqësore ishte edhe një vlerësim për shpërndarjen optimale të gjyqtarëve. Vlerësimi u bazua në një kategorizim të thjeshtë të çështjeve, duke i ndarë ato në çështje me një shkallë mesatare kompleksiteti, që kërkon më shumë kohë gjyqësore dhe burime nga gjykatat, si dhe çështje të thjeshta, të cilat kërkojnë më pak kohë dhe burime.

Struktura e përgjithshme paraqitet në tabelën e mëposhtme.

Vlerësimi u bë veçmas për çdo lloj çështjeje. Ndërsa kjo analizë do të na tregonte shpërndarjen optimale të gjyqtarëve mes rretheve gjyqësore, gjykatave të apelit të juridiksionit të përgjithshëm dhe gjykatave administrative të shkallës së parë dhe riorganizimit të kompetencave tokësore, në të nuk u përfshi vlerësimi sa i takon shpërndarjes optimale të gjyqtarëve në Gjykatën Administrative të Apelit, për shkak se kjo gjykatë nuk prekej nga riorganizimi i kompetencave tokësore të gjykatave. Kompetenca tokësore e Gjykatës Administrative të Apelit përcaktohet shprehimisht në nenin 12 të Ligjit 98/2016 “Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar. Sipas tij, Gjykata Administrative e Apelit organizohet dhe funksionon në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë, me seli në Tiranë.

Detyrimi i Këshillit për përcaktimin e numrit të përgjithshëm të gjyqtarëve buron nga neni 21 i Ligjit 98/2016 “Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë”, i cili parashikon se:

1. Këshilli i Lartë Gjyqësor propozon numrin e përgjithshëm të gjyqtarëve në Republikën e Shqipërisë bashkë me propozimin për buxhetin e sistemit gjyqësor, sipas procedurës së caktuar me ligj.

2. Përpara se të miratojë propozimin, Këshilli i Lartë Gjyqësor merr mendimin e Këshillave të Gjykatës, Ministrit të Drejtësisë, Ministrit të Financave dhe këshillohet me palë të tjera të interesuara, sipas rregullave të parashikuara në ligjin “Për njoftimin dhe konsultimin publik”.

3. Procesi i përcaktimit të numrit të përgjithshëm të gjyqtarëve mbështetet në

objektivat e parashikuar në nenin 14, të këtij ligji, si dhe kryhet në mënyrë transparente, duke u bazuar në vlerësime të plota të kritereve të administratës gjyqësore, siç përcaktohen nga neni 15 pika 3, shkronja “b”, e këtij ligji.

Sa më sipër, Këshilli tashmë e ka edhe një raport vlerësues të ngarkesës mbi të cilin mund të gjykojë për ndryshimin e numrit të gjyqtarëve në Gjykatën Administrative të Apelit dhe rrjedhimisht edhe ndryshimin e numrit të përgjithshëm të gjyqtarëve në Republikën e Shqipërisë.

Gjykata Administrative e Apelit aktualisht ka:

- 6 gjyqtarë në detyrë;
- 5 gjyqtarë në skemë delegimi;
- 2 gjyqtarë të shkarkuar nga KPK-ja, që janë në pritje të vendimit nga KPA-ja.

Numri i çështjeve të prapambetura dhe çështjeve të reja të regjistruara në Gjykatën Administrative të Apelit.

Në 29 shtator 2023, Gjykata Administrative e Apelit kishte 23.104 çështje të papërfunduara. Mosha mesatare e çështjeve të papërfunduara ishte 3.3 vjet. Merret në konsideratë çështje të prapambetura (backlog) quhen çështjet më të vjetra se një vit, duke u marrë në konsideratë kjo, çështjet më të vjetra janë 19.930 çështje.

Me qëllim analizimin e ngarkesës së gjykatës, në grafikën më poshtë, rezulton se Gjykata Administrative e Apelit që prej themelimit të saj ka pasur një numër të konsiderueshëm çështjesh të prapambetura. Që prej vitit 2015, numri i çështjeve në shqyrtim, pa vendim, e ka tejkaluar numrin 10.000. Sipas të dhënave të shtatorit 2023, numri i çështjeve të prapambetura arrin 22.643 çështje, ndërkohë që numri i çështjeve të reja që regjistrohen çdo vit në gjykatë është rreth 3.000-3.500 çështje.

Lloji i çështjeve në Gjykatën Administrative të Apelit sipas të dhënave statistikore, ndahen komplekse dhe të lehta.

Tabela më poshtë prezanton trendin e 10 llojeve të çështjeve gjyqësore të regjistruara në pjesën e parë të vitit 2023 në Gjykatën e Administrative të Apelit, që këto 10 lloje zënë 94 % të çështjeve të regjistruara.

Për sa i përket rivlerësimit të nevojës për gjyqtarë në gjykatat administrative.

Për të pasur një vlerësim të nevojës së përgjithshme për gjyqtarë të Gjykatës Administrative të Apelit është vijuar me prezumimin se kompleksiteti i çështjeve administrative është i krahasueshëm me një miks çështjesh civile themeli me palë kundërshtare dhe çështjesh penale themeli. Në mënyrë të ngjashme, është prezumuar se kërkesat e tjera administrative kanë të njëjtën shkallë kompleksiteti si çështjet civile pa palë kundërshtare. Është e qartë se një ushtrim më i thelluar për peshimin e çështjeve do të përmirësonte cilësinë dhe saktësinë e parashikimeve, por ky është një ushtrim që kërkon kohë dhe një studim të detajuar të kohës gjyqësore.

KLJG-ja është e detyruar të shpërndajë gjyqtarët në një mënyrë të tillë që ngarkesa mes gjyqtarëve të jetë e barabartë, për aq sa është e mundur. Kjo është një detyrë e vështirë për sa kohë nuk ka analiza të thelluara me studime të peshës së çështjeve dhe ngarkesës të të gjitha llojeve të gjykatave. Në kuadër të analizës lidhur me hartën e re gjyqësore, është kryer një analizë e thjeshtë e shpjeguar më lart, e bërë veçmas për çdo lloj gjykate. Por, analiza në fakt nuk synon të krahasonte ngarkesën e gjykatave të apelit me atë të shkallëve të para, ose ngarkesën e gjykatave administrative me atë të gjykatave të juridiksionit të përgjithshëm.

Nisur nga prezumimet e mësipërme është mundur të sigurohet një parashikim i përafërt mbi nevojën për gjyqtarë në Gjykatën Administrative të Apelit. Pas një analize të kombinuar të të gjithë indikatorëve, faktorëve dhe objektivave të parashikuar nga neni 14 i Ligjit Nr. 98/2016 i ndryshuar, është konkluduar se, nëse do të synohet ekuilibrimi i ngarkesës, Gjykata Administrative e Apelit do të ketë nevojë për të paktën 19 pozicione gjyqtarësh (krahasuar me 13 pozicione që ka aktualisht), si mekanizmi kryesor i ekuilibrit të ngarkesës së gjykatës dhe vetë gjyqtarëve, duke siguruar një rishpërndarje të drejtë të ngarkesës së gjyqtarëve në juridiksionin e apelit.

Për të përcaktuar ngarkesën e punës treguesit janë vlerësuar duke kërkuar vendosjen e një ekuilibri midis shpërndarjes së ngarkesës së punës, shpërndarjes së gjyqtarëve, si dhe numrit minimal të gjyqtarëve në çdo gjykatë. Ngarkesa e gjykatës është përcaktuar jo vetëm nga numri total i çështjeve të reja, por edhe nga lloji i këtyre çështjeve, pra nëse çështjet e ndërlikuara dhe ato që marrin kohë përbëjnë përqindjen më

të vogël apo atë më të madhe të çështjeve në ngarkesë.

Rivlerësimi i nevojës për rritjen e numrit të përgjithshëm të gjyqtarëve në Republikën e Shqipërisë.

Në përfundim të analizës, numri i përgjithshëm i gjyqtarëve për shkak të rritjes së numrit të gjyqtarëve në Gjykatën Administrative të Apelit me 6 gjyqtarë (pra nga 13 ne 19) do të duhej të rritej nga 408 pozicione në 414 pozicione të ndara si më poshtë:

Numri i gjyqtarëve në gjykatat e shkallës së parë të juridiksionit të përgjithshëm (sipas vendimit të KLGJ nr. 146, datë 29.03.2023) është në këtë mënyrë:

Në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Berat, 8 (tetë) gjyqtarë.

Në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Dibër, 7 (shtatë) gjyqtarë.

Në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës, 23 (njëzet e tre) gjyqtarë.

Në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan, 18 (tetëmbëdhjetë) gjyqtarë.

Në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Fier, 21 (njëzet e një) gjyqtarë.

Në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Gjirokastrë, 7 (shtatë) gjyqtarë.

Në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Korçë, 15 (pesëmbëdhjetë) gjyqtarë.

Në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Kukës, 7 (shtatë) gjyqtarë.

Në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Lezhë, 11 (njëmbëdhjetë) gjyqtarë.

Në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Sarandë, 7 (shtatë) gjyqtarë.

Në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Shkodër, 15

(pesëmbëdhjetë) gjyqtarë.

Në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, 80 (tetëdhjetë) gjyqtarë.

Në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Vlorë, 16 (gjashtëmbëdhjetë) gjyqtarë.

-Numri i gjyqtarëve në gjykatat administrative të shkallës së parë është (sipas Vendimit të KLGJ nr. 286, datë 29.05.2023):

Në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, 27 (njëzet e shtatë) gjyqtarë.

Në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Lushnjë, 9 (nëntë) gjyqtarë.

-Numri i gjyqtarëve në gjykatat e posaçme për gjykimin e veprave penale të korrupsionit dhe krimit të organizuar është si më poshtë:

Numri i gjyqtarëve në Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë për gjykimin e veprave penale të korrupsionit dhe krimit të organizuar është 16 (gjashtëmbëdhjetë) gjyqtarë.

Numri i gjyqtarëve në Gjykatën e Posaçme të Apelit për gjykimin e veprave penale të korrupsionit dhe krimit të organizuar është 11 (njëmbëdhjetë) gjyqtarë.

-Numri i gjyqtarëve në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm është 78 (shtatëdhjetë e tetë) gjyqtarë (sipas Vendimit të KLGJ nr. 553, datë 29.12.2022).

-Numri i gjyqtarë në Gjykatën e Lartë është 19 (nëntëmbëdhjetë) gjyqtarë.

-Numri i propozuar gjyqtarëve në Gjykatën Administrative të Apelit është 19 (nëntëmbëdhjetë) gjyqtarë.

Projektvendimi është i përbërë në këtë formë:

Në pikën 1 përcaktohet miratimi i raportit vlerësues të grupit të punës për hartimin e strategjisë për uljen e numrit të çështjeve të prapambetura në gjykata për rritjen e numrit të përgjithshëm të gjyqtarëve të Republikës së Shqipërisë.

Në pikën 2 të projektvendimit përcaktohet përcjellja e raportit vlerësues të miratuar nga Këshilli i Lartë Gjyqësor, për të vijuar me marrjen e mendimit e Këshillave të Gjykatës, Ministrisë të Drejtësisë dhe Ministrisë të Financave.

Në pikën 3 të projektvendimit ngarkohet Drejtoria e Shërbimeve Juridike për këshillimin me palë të tjera të interesuara sipas rregullave të parashikuara në ligjin “Për njoftimin dhe konsultimin publik”.

Së fundi, përcaktohet hyrja në fuqi e tij, konkretisht menjëherë me publikimin në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Faleminderit!

Naureda Llagami: Shumë faleminderit z. Hado për relatimin e këtij akti, që në fakt nuk është akt përfundimtar sepse do t’i nënshtrohet një konsultimi me Ministrin e Drejtësisë dhe me Ministrin e Financave dhe pas konsultimit Këshilli do ta miratojë në mënyrë përfundimtare propozimin për rritjen e numrit të përgjithshëm të gjyqtarëve.

Unë në fakt ia jap fjalën kolegëve nëse kanë ndonjë sugjerim, nëse mendojnë diçka. Po, zoti Kurushi!

Klodian Kurushi: Faleminderit zonja Kryetare!

Në lidhje me projektvendimin dhe relacionin e parashtruar sot dhe të paraqitur nga zoti Hado, unë dakordësohem pjesërisht dhe jo plotësisht me të. Dua të bëj një propozim alternativ referuar numrit të përgjithshëm të gjyqtarëve dhe numrit të gjyqtarëve në Gjykatën Administrative të Apelit. E bëj këtë propozim, të cilin unë do ta parashtoj më poshtë, duke u referuar dhe duke qenë, mendoj unë, në sinkron edhe me planin strategjik që ne sapo e miratuam në pikën e parë të rendit të ditës, ku në këtë plan, ndërmjet të tjerave, referuar vetëm Gjykatës së Apelit Administrativ është projektuar që deri në vitin 2027, me masat që ne do marrim edhe me këto propozime që bëjmë për rritjen e numrit të gjyqtarëve, do të ulet 20 deri në 30 % e numrit të çështjeve, ku në total mund të hiqeshin, sipas një përlllogaritjeje, rreth 5.000 çështje. Në këtë pikë, unë mendoj që për të rritur po themi performancën e Gjykatës së Apelit Administrativ, duke shtuar më tej numrin e burimeve njerëzore, pra numrin e gjyqtarëve në Gjykatën e Apelit Administrativ (dhe ky është propozimi im), mendoj që kjo masë e propozuar nga ana juaj por edhe nëpërmjet një propozimi alternativ që unë do ta parashtoj përpara Këshillit,

mundet të uli efektet negative të backlog-ut të çështjeve që gjykohen në Gjykatën e Apelit Administrativ.

Më duhet të them se Gjykata e Apelit Administrativ është gjykatë e vetme në Republikën e Shqipërisë. Çështjet që gjykohen në Gjykatën e Apelit Administrativ dhe përgjithësisht çështjet me natyrë administrative ndjekin ca rregulla të veçanta, ku ndërmjet të tjerave është edhe rasti i respektimit të afateve kohore brenda të cilave gjykata duhet të shpalli vendimin në një pjesë të mirë të këtyre çështjeve.

Ndodhur në këto kushte, unë do propozoja që numri i gjyqtarëve në Gjykatën e Apelit Administrativ, nga 6 e shtuar, pra 13 (6 propozon Komisioni), unë mendoj të shtohet edhe një treshe tjetër, pra nga 13, të mos shkojë në 19 por të shkojë në 22, pra edhe një trup tjetër gjykues prej 3 gjyqtarësh. Besoj se janë mundësitë për të mbështetur këtë propozim për arsye sepse do të ndikojë në komponentin e gjykimit të çështjeve brenda një afati të arsyeshëm kohor (kur bëhet fjalë për çështje me natyrë administrative). Realisht, nëse do t'i qëndrojmë këtij propozimi, atëherë duhet të ndryshojë edhe numri i përgjithshëm i gjyqtarëve, nga 408 plus 6, tani do shkojë në 408 plus 9, gjithsej është 417 gjyqtarë.

Pra këto janë dy propozimet e mia. E para, numri i gjyqtarëve në Gjykatën e Apelit Administrativ të shkojë në total plus 22 dhe numri i përgjithshëm i gjyqtarëve, më pas të reflektojë tek ky ndryshim, të shkojë në 417. Nuk e di se sa i qartë isha. Faleminderit!

Naureda Llagami: Po, zonja Plaku!

Irena Plaku: Atëherë, jo se nuk jam dakord në parim që ne të kemi aktualisht një numër të lartë të gjyqtarëve, por numri i gjyqtarëve nuk caktohet në bazë të numrit të çështjeve të prapambetura por caktohet në bazë të numrit të çështjeve të ardhura. Nga analiza e të dhënave statistikore, referuar numrit të çështjeve të ardhura por edhe atë që synon Këshilli i Lartë Gjyqësor, që të ketë një balancim të ngarkesës në të gjithë gjykatat e Republikës së Shqipërisë, numri i çështjeve sipas të dhënave statistikore, numri i

gjqtarëve shkonte në 18, jo në 22 domethënë. Kjo është bërë nga një analizë e të dhënave statistikore, nuk është bërë sipas dëshirave tona me pak fjalë, por aq sa është numri i çështjeve të regjistruara çdo vit, dhe është propozuar një numër, me dakordësinë edhe të trupës gjyqësore, dakordësinë e trupës së Gjykatës Administrative, është shtuar në fakt një numër, duke e çuar në 19, duke u nisur nga ideja që të kemi një numër lidhur me trupat gjykues dhe është shtuar një numër, duke shkuar në 19. Të dhënat statistikore nuk e lejojnë rritjen e numrit të gjyqtarëve me 22. Pra numri i gjyqtarëve nuk caktohet në bazë të çështjeve të prapambetura, pasi në momentin që ne caktojmë një gjyqtar në Gjykatën e Apelit Administrativ apo në çdo gjykatë tjetër, ne nuk e heqim dot më.

Qëllimi i Këshillit nuk është vetëm të caktojë gjyqtarë, por edhe të ketë një ngarkesë të balancuar të të gjithë gjykatave. Gjykata Administrative e Apelit ka ardhur gjithmonë duke u rritur numri i gjyqtarëve për shkak se ka ndryshuar edhe kompetencat lëndore të çështjeve, edhe për shkak të vendimeve të Gjykatës së Lartë, dhe ka qenë fillimisht 7 (me sa mbaj mend), dhe shkoi në 13. Aktualisht, pasur parasysh numrin e çështjeve të regjistruara, dhe thashë jo numrin e çështjeve të prapambetura, strategjia po, ka pasur parasysh që ka propozuar këtë rritje numri, në bazë të numrit të çështjeve të regjistruara, ndërsa për uljen e backlog-ut është parashikuar që veç këtyre të kemi staf mbështetës. Nuk është e nevojshme të rritet numri i gjyqtarëve, por është propozuar staf mbështetës. Konkretisht në ndryshimet ligjore është propozuar që të kemi 2 ndihmës ligjorë, dhe që të rritet puna efektive e gjyqtarëve, gjithashtu është propozuar, me qëllim duke pasur parasysh që kemi pasur probleme në marrjen e stafit (ndihmësve ligjorë), është propozuar që mos të kalojnë më nëpërmjet Shkollës së Magjistraturës, por është bërë një propozim që nëpërmjet Këshillave të Gjykatës apo edhe Këshillit të Lartë Gjyqësor. Të ketë disa alternativa se si mund të merret staf tjetër mbështetës (duke rritur numrin e stafit), jo vetëm këshilltarët por të gjithë stafit, kjo edhe sipas kërkesave të gjykatës (gjykatës administrative por edhe gjykatave të tjera).

Pra unë mendoj që ne nuk mund të shkojmë në një numër 22. Jo se nuk është dëshira, por gjyqtarët caktohen në bazë të numrit të çështjeve të ardhura për regjistrim. Kështu që unë i qëndroj propozimit prej 19 sepse është analiza e të dhënave statistikore

dhe jo e dëshirës sonë me pak fjalë.

Klodian Kurushi: Faleminderit!

A mundem?

Naureda Llagami: Po!

Fatmira Luli: Sa është numri i çështjeve që keni nxjerrë ju me statistika mbi bazën e çështjeve të ardhura për gjyqtar në Gjykatën e Apelit Administrativ?

Sa është ngarkesa?

(Disa nga anëtarët komunikojnë pa ndezur mikrofonat.)

Naureda Llagami: Ajo që pyet Fatmira është: Nga analiza e të dhënave që keni bërë në tre vite (ku e keni shtrirë analizën), sa është numri i çështjeve të reja të regjistruara në vite progresive për Gjykatën e Apelit Administrativ?

Fatmira Luli: Për gjyqtar, sa i bie ngarkesa?

Naureda Llagami: E keni marrë me 13 njëherë sa ka qenë dhe keni bërë propozimin me 19. Pra mesatarisht është 3.000 – 3.500 çështje në vit.

Fatmira Luli: Sa i bie norma?

(Disa nga anëtarët komunikojnë pa ndezur mikrofonat.)

Naureda Llagami: Atëherë, unë do propozoja që këtë çështje ne ta verifikojmë dhe gjatë periudhës së konsultimit që kemi me institucionet, t'i rikthehemi prapë për ta parë edhe një herë si e mendoni, për shkak të statistikave, që t'i vlerësojmë edhe një herë

statistikat. Pra ne ta mbyllim me këtë propozim që ka grupi i punës. Fillon procesi i konsultimit sepse duhet që t'ia çojmë Ministrit të Drejtësisë, Ministrit të Financave, me argumente, dhe në këtë proces grupi i punës ta rishikojë edhe një herë me perspektivën që thotë z. Kurushi.

Kalojmë në votim parimisht njëherë kështu dhe e vlerësojmë në një moment?

(Zonja Llagami kërkon që kur të flitet anëtarët të ndezin mikrofonat.)

Klodian Kurushi: A mund të bëj edhe një koment unë?

Dakord me çfarë u diskutua. Por ju i jeni referuar situatës historike të krijimit të gjykatës së apelit dhe gjykatave administrative në përgjithësi. Por nga koha e krijimit të gjykatave administrative që ishin me 7, u bënë me 13, deri sot ne po përballemi me një progresion ndryshimesh legjislative që e kanë zgjeruar juridiksionin e gjykatave administrative, pra nga çështjet me natyrë tradicionale administrative, sot gjykatat administrative gjykojnë çështje të tjera shtesë. Këtu unë llogaris dhe fus edhe vendimet që marrin institucione të tjera ku Gjykata e Apelit Administrativ bëhet si gjykatë e shkallës së parë në gjykime në një kategori çështjesh dhe në këtë pikë mua nuk më ndalon të mendoj që nesër po ky legjislator do ta shtojë më tepër juridiksionin dhe fushën e gjykimit si gjykatë e shkallës së parë për gjykatat administrative. Në këtë pikë, duke parë në projektion situatën kur është krijuar, si ka evoluar juridiksioni i gjykatave administrative, duke marrë parasysh se e keni thënë vetë –edhe natyrën e çështjes – por e keni thënë edhe vetë në strategji që shiko se kemi edhe këtë backlog-un. Është e vërtetë që ky backlog-u në mënyrë statistikore... e di, është e vërtetë kjo pjesa, por ajo është atje, gjendje fakti, është atje dhe është në fund fare është kosto për qytetarët, që edhe administrativisht ne kemi krijuar gjykatat për të gjykuar brenda një afati të arsyeshëm, qytetarët nuk do ta marrin këtë shërbim dhe nuk është pak, por është shumë backlog-u edhe në gjykatën e apelit administrativ. Atëherë këto masa propozohen nga ana juaj, jam dakord statistikisht, jam dakord me atë pjesën, por unë vazhdoj ta them, nuk jemi shkencë ekzakte dhe legjislatori i ka dhënë të drejtën dhe detyrimin gjykatës administrative të

gjykojë si shkallë e parë në një kategori të caktuar çështjesh, që asnjëherë nuk mund të mbyllen me një seancë. Dhe mund të na krijojë prapë probleme të tjera, referuar edhe kompleksitetit të çështjeve. Kështu që në këtë pikë unë mendoj, për sa kohë e kemi mundësi për të bërë propozimin, se në fund fare nuk do ta zgjidhim në këtë çështje sepse është një çështje që nuk varet tërësisht nga dëshira dhe vullneti i Këshillit të Lartë Gjyqësor. Atëherë, pse mos të shtojmë edhe një trup tjetër gjykues kur mundësia ekziston sot dhe në sot po marrim hapa jashtëzakonisht të rëndësishëm strategjik për të ulur backlog-un dhe për të marrë masa të tjera të rëndësishme, me qëllim që të respektojmë kundrejt qytetarëve që ata të marrin shërbimin e duhur ligjor brenda një afati të arsyeshëm kohor. Kështu që në këtë pikë, propozimi im i referohet pikërisht këtyre rrethanave të tjera, jo asaj me natyrë statistikore. Pra referuar atyre elementeve që unë thashë, unë propozoj (mos e merrini në konsideratë), referuar këtyre situatave, propozoj që edhe një trup tjetër gjykues për një gjykatë administrative të apelit, që është e vetmja në Shqipëri, nuk do t'i bënte keq jo gjykatës, jo sistemit gjyqësor, por shërbimit që ajo do të ofrojë në respektim të afatit të arsyeshëm kohor për qytetarët që do t'i drejtohen asaj gjykate. Faleminderit!

Naureda Llagami: Po, zoti Toro!

Alban Toro: Ndoshta do më duhet ta kontestoj kolegun sepse argumentimi për të rritur numrin e gjyqtarëve tej propozimit që ka bërë grupi i punës nuk më rezulton shumë bindës për shkakun se aktualisht kemi të bëjmë me një gjykatë të cilën e kemi nën monitorim për shkak se ka një historik të vajtueshëm performance. Që do të thotë, në prezencën e një performance të dobët, unë nuk mund të fajësoj ngarkesën që kanë aktualisht për shkak të juridiksionit që i paska caktuar ligjvënësi. Mos harrojmë që juridiksione të shtuara kanë edhe apeli i juridiksionit të përgjithshëm, por nuk shikoj të njëjtin nivel entuziazmi për të riparuar backlog-un që ka ky apel apo për të shtuar numrin apo për të gjetur mjete efikase për të ndihmuar këtë gjykatë apo Gjykatën e Lartë (që të mos kufizohem vetëm tek apeli) për backlog-un që ata kanë. Kështu që, duke qenë që

kemi një situatë të një gjykate që e kemi nën monitorim për shkak se i kemi vendosur në dispozicion ca trupa të freskëta gjyqësore (nëpërmjet skemës së delegimit), të shikojmë njëherë si kanë reaguar dhe pastaj të përpiqemi të verifikojmë dhe të dhënat që ka grupi i punës. Me një llogaritje të thjeshtë me çështje të ardhura prej 3.000 çështjesh në vit, të pjesëtuara me 19 gjyqtarë, të cilët ne pretendojmë t'i bëjmë, na del një mesatare 150 e ca çështje për gjyqtar. Kështu që ngarkesë në raport me gjykatat e tjera... duke ditur edhe procedurën që gjykojnë mbi bazë aktesh, më së shumti në dhomë këshillimi.

Naureda Llagami: Atëherë, unë mendoj që propozimi që ka z. Kurushi mund ta shqyrtojmë edhe një herë, nga ana e grupit të punës, grupi këtu është, t'i shohim edhe një herë të dhënat; dhe ajo që duhet të shohim në fakt është edhe propozimet ligjore që kemi dhe a mundet që në këto propozime ligjore të lehtësohet backlog-u i gjykatës apo shpejtësia e gjykimit sepse ajo që ka synim gjykata administrative në ndryshim nga çdo gjykatë tjetër është shpejtësia e gjykimit. Afatin ligjor e kanë të gjithë, por aty ka një gjë më shumë që është edhe shpejtësia, që brenda 60 ditëve prezumohet që ti duhet të mbarosh gjykimin administrativ. Arrijmë ne dot me këto norma ta mbarojmë? Ne aty kemi vendime që prishen nga Gjykata Kushtetuese për konstatim të procesit të rregullt ligjor. Kështu që në këtë perspektivë unë do doja që ta rishikonim në këtë që a kemi mundësi që kjo gjë do ndikonte, ndryshe pastaj mbetemi me propozimin. Por unë do sugjeroja, të vijojmë me këtë propozim dhe grupi i punës, sa të vijmë mendimet nga ministritë, bën edhe një analizë tjetër të të dhënave, aq më shumë të afateve kohore (që ndryshon pjesa në rastin e gjykimit administrativ) dhe më pas... Ne e kemi lënë në fakt për këta që kemi çuar që duhet t'i mbanim atje për performancën që kanë. Kështu i kemi thënë kur i kemi deleguar. Kjo është pjesa që thotë Albani sepse në fakt është gjykata e cila, në të gjithë vlerësimet që kemi pas, performanca nuk ka qenë ajo që ne kemi në gjykata. Në qoftë se një gjyqtar i apelit në gjykatën e përgjithshme gjykon 500, 400, 380 çështje (600-700 kam parë unë çështje), por deri tek 500 e ca patjetër, është mesatarja, shohim tjetër qasje të gjykatës administrative, që në fakt duhet të jetë edhe më shpejt edhe për shkak të natyrës sepse është më e fokusuar në llojin e çështjeve.

Kështu që dhe unë jam pak në dilemë në fakt me pjesën e propozimit të Klodit. Do doja që grupi t'i shihte edhe një herë të dhënat dhe të na bënte ndoshta një pasqyrë të të dhënave edhe pse jo ta shihni në raport me kohën dhe vitet.

Fatmira Luli: I bie që ne të kemi 10 vjet. I thonë 10 vjet pritje. Çështjet në Gjykatën Administrative janë të 2016. Planifikimi në 2026 e çon tek 10-vjetëshi. Ne po marrim masa për backlog-un, nuk po marrim masa për të krijuar një gjykatë që të gjykojë me komoditet. Në këto kushte duhen masa speciale. Kështu që unë e mbështes propozimin që ndoshta për të tëra gjykatat mund të jetë e nevojshme që të bëhet shtim.

Naureda Llagami: Atëherë, kalojmë në votim fillimisht me propozimin që kemi me këtë rezervën që të rishikojmë edhe një herë të dhënat.

Po jo pra, e lamë dakord me Klodin që neve do pranojmë në këto momente këtë propozim sepse personalisht mendoj që na duhen të dhënat.

Kalojmë në votim propozimin me këtë rezervën që grupi i punës të na bëjë një pasqyrë të të dhënave ndër vite, që nga momenti kur është themeluar ajo gjykatë. Ne duhet të shohim se si progresivisht asaj gjykate i është rritur ngarkesa, ku ka pësuar ngarkesën dhe ku është backlog-u, dhe çështjet e reja nga fillimi i saj deri më sot.

Klodian Kurushi: Backlog-u është për shkak të mungesës së gjyqtarëve apo për shkak të çështjeve?

Naureda Llagami: Për këtë të bëjmë një analizë të të dhënave.

Kështu që unë pranoj që ta hedhim në votim propozimin e grupit të punës fillimisht me këtë rezervë, që të bëjmë një analizë ndërkohë.

Ok, kalojmë në votim njëherë!

Ilir Rusi: Dakord me propozimin e grupit të punës.

Irena Plaku: Unë jam dakord me grupin e punës. Në fakt doja të shtoja që përcaktimi i numrit të gjyqtarëve është bërë në bazë të të dhënave statistikore ku ka

rezultuar në raport edhe me gjykatën e apelit të përgjithshëm ngarkesa me numrin e çështjeve të ardhura është më i ulët në krahasim me gjyqtarët e apelit të juridiksionit të përgjithshëm si dhe është bërë edhe me llojin e vështirësisë së çështjeve. Kështu që unë jam dakord.

Gentiana Muçaj: Dakord.

Ridvan Hado: Dakord.

Alban Toro: Dakord.

Fatmira Luli: Dakord.

Markelian Koça: Dakord që të rishqyrtohet nga grupi i punës mbi bazën e propozimit të zotit Kurushi.

Yllka Rupa: Dakord.

Emona Muçi: Dakord.

Klodian Kurushi: Dakord, por duke iu referuar edhe propozimit që bëri Kryetarja që ky projektvendim të rishikohet edhe një herë duke u integruar me analizën e numrit të çështjeve që ka gjykuar ndër vite Gjykata Administrative e Apelit. Faleminderit!

Naureda Llagami: Dakord.

Atëherë Këshilli vendosi:

1. Miratimin e raportit vlerësues të grupit të punës për hartimin e strategjisë për uljen e numrit të çështjeve të prapambetura në gjykata për rritjen e numrit të përgjithshëm të gjyqtarëve në Republikën e Shqipërisë, sipas tekstit bashkëlidhur këtij vendimi dhe pjesë përbërëse e tij.

2. Përcjelljen e raportit vlerësues të miratuar nga Këshilli i Lartë Gjyqësor, për të vijuar me marrjen e mendimit të Këshillave të Gjykatës, Ministrit të Drejtësisë dhe Ministrit të Financave.

3. Ngarkohet Drejtoria e Shërbimeve Juridike për këshillimin me palë të tjera të interesuara sipas rregullave të parashikuara në ligjin “Për njoftimin dhe konsultimin publik”.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë me publikimin e tij në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

* * *

(Pika 2 e rendit të ditës)

Për Këshillin e Lartë Gjyqësor



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____.____.2024

PROCESVERBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR

(Mbledhje e realizuar me video konferencë)

(Mbajtur, më 09.05.2024)

Pika 3 e rendit të ditës me objekt: Shqyrtimi i projekt-udhëzimit “Për miratimin e kriterëve dhe procedurave për analizimin dhe klasifikimin e çështjeve të prapambetura dhe çështjeve të reja që regjistrohen në gjykatë”, përgatitur nga Grupi i Punës "Për hartimin e strategjisë për uljen e numrit të çështjeve të prapambetura në gjykata (anëtarët z. Ilir Rusi, z. Ridvan Hado dhe znj. Irena Plaku).

Drejton mbledhjen Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, zonja Naureda Llagami.

Mbledhja u zhvillua në sallën e mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 11:10 dhe mbaroi në orën 13:48.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

- | | |
|--------------------|-------------------|
| 1. Naureda Llagami | (kryetare) |
| 2. Ilir Rusi | (zëvendëskryetar) |
| 3. Klodian Kurushi | (anëtar) |
| 4. Fatmira Luli | (anëtare) |
| 5. Irena Plaku | (anëtare) |
| 6. Gentiana Muçaj | (anëtare) |
| 7. Ridvan Hado | (anëtar) |

8. *Alban Toro* (anëtar)
9. *Markelian Koça* (anëtar)
10. *Yllka Rupa* (anëtare)
11. *Emona Muçi* (anëtare)

Morën pjesë gjithashtu nëpërmjet platformës dhe në sallë:

1. *Rudin Baqli, Sekretar i Përgjithshëm.*
2. *Blerta Ngucaj, Drejtore e Departamentit të Shërbimeve Juridike dhe Marrëdhënieve me Jashtë.*
3. *Luan Dibra, Rezarta Taushani, Gentiana Agushi, Këshilltarë pranë Komisioneve të Përhershme në Këshill.*
4. *Denisa Varfi dhe Entela Dobi, përfaqësuese të Ministrisë së Drejtësisë.*
5. *Arturo Valdes dhe Arben Lila, përfaqësues të Projektit EU4Justice. (në sallë)*
6. *Olta Lolo dhe Valbona Bala, përfaqësuese të EWMI/INL. (në sallë)*
7. *Sidorela Driçi, AIS Instituti Shqiptar i Shkencës (prezent në një pjesë të mbledhjes).*
8. *Staf nga administrata e KLGJ-së.*

RENDI I DITËS:

3. Shqyrtimi i projekt-udhëzimit “Për miratimin e kriterëve dhe procedurave për analizimin dhe klasifikimin e çështjeve të prapambetura dhe çështjeve të reja që regjistrohen në gjykatë”, përgatitur nga Grupi i Punës "Për hartimin e strategjisë për uljen e numrit të çështjeve të prapambetura në gjykata (anëtarët z. Ilir Rusi, z. Ridvan Hado dhe znj. Irena Plaku).

Naureda Llagami: Kalojmë tashmë tek projekt-akti tjetër i cili ka të bëjë me një projekt-udhëzim “Për miratimin e kriterëve dhe procedurave për analizimin dhe klasifikimin e çështjeve të prapambetura dhe çështjeve të reja që regjistrohen në gjykatë”. Edhe ky është një akt pjesë e masave të cilat ne marrim për pjesën e strategjisë dhe

ndërhyrjeve për backlog-un nëpër gjykata, duke kuptuar natyrën dhe duke analizuar natyrën dhe kategorizuar çështjet.

Për më shumë detaje fjalën ia jap z. Rusi.

Ilir Rusi: Faleminderit e nderuar Kryetare!

Unë nuk do të thoja falënderime, por do të theksoja faktin e besimit që na dhanë autoritetet përkatëse së bashku me partnerët ndërkombëtarë për të qenë pjesë e këtij grupi pune.

Si paketë e akteve është edhe ky projekt-udhëzim, që në thelb është inventarizimi i çështjeve.

Në lidhje me detyrimin ligjor për nxjerrjen e aktit -

Këshilli i Lartë Gjyqësor, bazuar në shkronjën “ë”, të pikës 1, të nenit 147/a të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe në shkronjën “e”, pika 4, të neneve 89 dhe 94 të Ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar, është institucioni përgjegjës për hartimin dhe ndjekjen e zbatimit të politikave të administrimit gjyqësor; monitorimin dhe menaxhimin e ngarkesës së gjyqtarëve dhe gjykatave, kohëzgjatjen e çështjeve bazuar në të dhëna të besueshme dhe miratimin e rregullave të brendshme standarde për gjykatat me qëllim përmirësimin e produktivitetit të gjykatave dhe rritjes së shpejtësisë së gjykimit.

Në lidhje me natyra e aktit dhe harmonizimi i tij me kuadrin ligjor -

Për zbatim të detyrimeve ligjore parashikuara në nenin 89 dhe 94 të ligjit nr.115/2016, “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar, Këshilli i Lartë Gjyqësor detyrohet të krijojë mekanizma për zgjidhjen e problemeve funksionale dhe shpërndarjen e ekuilibruar të ngarkesës midis gjyqtarëve dhe gjykatave, të miratojë veprime standarde që ndërmerren në rastin e tejkalimit të afateve të shqyrtimit të çështjeve si dhe të hartojë udhëzues për mbajtjen e statistikave gjyqësore me qëllim rritjen e efikasitetit dhe cilësisë së gjykatave.

Këshilli i Lartë Gjyqësor vlerëson nevojën e rregullimit me anë të një akti të veçantë për përcaktimin e kritereve dhe procedurave për analizimin dhe klasifikimin e

çështjeve të prapambetura dhe çështjeve të reja që regjistrohen në gjykata, i cili do të sjellë një situatë më të qartë dhe të detajuar mbi ngarkesën me çështje të gjykatave të apelit (juridiksioni i përgjithshëm dhe administrativ), llojet e çështjeve dhe natyrën e veçantë të tyre me qëllim përpunimin e tyre sa më të shpejtë.

Për këtë arsye, propozohet përpara Këshillit miratimi i projekt-udhëzimit “Për miratimin e kriterëve dhe procedurave për analizimin dhe klasifikimin e çështjeve të prapambetura dhe çështjeve të reja që regjistrohen në gjykata”.

Për sa i përket përputhshmërisë së aktit me standardet ndërkombëtare -

Rregullat e parashikuara në projekt-akt janë mbështetur në rekomandimet dhe praktikën më të mira ndërkombëtare, por edhe të pilotuara më parë pranë Gjykatës së Lartë falë mbështetjes së Projektit për Uljen e Çështjeve të Prapambetura të INL-së dhe EËMI.

Në lidhje me konsultimin e aktit -

Projekt-akti i paraqitur për miratim është produkt i një procesi gjithëpërfshirës, duke reflektuar një kontribut të përbashkët të anëtarëve të grupit të punës ku bëjnë pjesë edhe drejtuesit e gjykatave ku këto rregulla do të gjejnë zbatim, dhe të partnerëve ndërkombëtare.

Në lidhje me komentet mbi aktin

Ky projekt-udhëzim vjen në kuadër të nevojës për parashikimin e veprimeve të qarta, standarde e të efektshme, të cilat duhet të zbatohen për grupimin e çështjeve sipas llojit e natyrës me qëllimin përfundimtar rritjen e efikasitetit, cilësisë e shpejtësisë së gjykimit të tyre dhe uljen e çështjeve të prapambetura, si një akt i rëndësishëm i cili plotëson njëkohësisht disa nevoja të sistemit gjyqësor.

Projekt-udhëzimi është një mjet që mund të përdoret nga kryetarët e gjykatave për rritjen e efikasitetit në gjykata dhe krijon mekanizma për uljen e kohëzgjatjes së shqyrtimit të çështjeve, përmes njohjes së ngarkesës me çështje aktive, grupimin dhe prioritizimin e tyre sipas përparësisë me qëllim likuidimin sa më të shpejtë të çështjeve më të vjetra në gjykatë, uljen e ndjeshme të çështjeve të prapambetura por edhe parandalimin e krijimit të tyre në të ardhmen.

Inventarizimi i ngarkesës me çështje aktive (pra të shqyrtuara nga gjykata) është një mjet i fortë dhe shumë i nevojshëm që ndihmon me të gjitha aspektet e organizimit dhe menaxhimit të brendshëm të gjykatës me qëllim rritjen e produktivitetit dhe efikasitetit të shqyrtimit të çështjeve.

Për sa i përket shpjegimit të detajuar i përmbajtjes së aktit

Në lidhje me përmbajtjen e projekt-vendimit, ai është organizuar në 9 pika të organizuar në rrjedhë logjike sipas praktikës së punës që do të kryejë gjykata.

Në pikën e parë parashikohen gjykatat që do të zbatojnë këtë proces: Gjykata e Apelit e Juridiksionit të Përgjithshëm dhe Gjykata Administrative e Apelit; zyrën përkatëse brenda strukturës së tyre të ngarkuar posaçërisht me mbarëvajtjen e këtij procesi: Zyra e regjistrimit, si dhe detyrimin për qëndrueshmërinë e procesit duke parashikuar analizimin e klasifikimin e jo vetëm çështjeve të prapambetura por edhe atyre të reja që regjistrohen rishtazi.

Në pikën e dytë, parashikohet se analizimi dhe klasifikimi i çështjeve bëhet në radhë të parë duke ndjekur radhën kronologjike të regjistrimit të tyre në gjykata nga nëpunësi civil gjyqësor, përgjegjës i caktuar për këtë qëllim nga gjykata.

Në lidhje me pikën tre që ka të bëjë me veprimet konkrete që duhet të ketë parasysh nëpunësi civil gjyqësor gjatë procesit të analizimit dhe klasifikimit të çështjeve; duke filluar nga verifikimi i akteve të dosjes:

a) Verifikohet nëse në dosjen gjyqësore janë administruar fashikulli i gjykimit të kryer në shkallë të parë si dhe fashikulli i gjykimit të krijuar në gjykatën e apelit dhe Gjykatën e Lartë (nëse çështja është kthyer për rigjykim).

b) Verifikohet praktika e plotë me të cilën është vënë në lëvizje gjykata e apelit, e cila duhet të përmbajë mjetin procedural me të cilin është investuar gjykata, i cili, sipas rastit mund të jetë: ankim; ankim i veçantë; kërkesë, në rastin kur ligji parashikon paraqitjen e saj drejtpërdrejtë në gjykatën e apelit sipas parashikimeve ligjore.

c) Verifikohet nëse praktika përmban vendimin e gjyqtarit të vetëm me të cilin është pranuar shqyrtimi i ankimit, apo i ankimit të veçantë, në përputhje me parashikimet ligjore.

d) Verifikohet pala që ka investuar gjykatën e apelit nëpërmjet ushtrimit të ankimit; ankimit të veçantë, ose kërkesës, si dhe pozicioni procedural që ka në gjykim. Subjekti që ka investuar gjykatën e apelit duhet të identifikohet si palë pjesëmarrëse në procesin gjyqësor të zhvilluar në gjykatën më të ulët, si dhe cilin pozicion procedural ka mbajtur. E duke vijuar me verifikimin e elementëve kryesorë të çështjes:

- a) Numri i regjistrimit themeltar të çështjes së regjistruar në gjykatën e apelit;
- b) Data e regjistrimit të saj në gjykatën e apelit;
- c) Gjyqtari relator që është shortuar për shqyrtimin e saj;
- d) Gjykata nga vjen çështja;
- e) Palët ndërgjyqëse, sipas pozicionit procedural në gjykim;
- f) Llojin e çështjes sipas listës së kategorive kryesore civile, penale, administrative;
- g) Përshkrimin e çështjes sipas listës së nënkategorive, kryesore, civile, penale, administrative;
- h) Nëse çështja përfshihet në listën e çështjeve prioritare sipas vendimit nr. 78, datë 30.05.2019, të Këshillit të Lartë Gjyqësor, i ndryshuar;
- i) Objekti i mosmarrëveshjes;
- j) Baza ligjore;
- k) Vendimi i dhënë nga shkalla e parë e gjykimit, e cila do të identifikohet me këto të dhëna: - numër, -datë, - llojin e vendimit të dhënë.
- l) Vlera e padisë;
- m) Nëse çështja është kthyer për rigjykim.

Pasi janë identifikuar elementët kryesorë të mosmarrëveshjes objekt shqyrtimi, nëpunësi civil gjyqësor kryen edhe një identifikim paraprak nëse mjeti procedural që ka investuar gjykatën e apelit është paraqitur brenda apo jashtë afatit; ka ose jo të meta; është bërë kundër një vendimi ndaj të cilit lejohet apo nuk lejohet të behët ankim; është bërë nga një person që legjitimohet apo jo që të bëjë ankim; është hequr dorë ose jo nga ankimi/ankimi i veçantë, për të ndihmuar gjykatën për të vlerësuar vijimësinë e shqyrtimit të çështjes.

Në pikën katër parashikohet se analizimi dhe klasifikimi i çështjeve në kategori dhe nënkategori do të bëhet sipas bazës së të dhënave së përgatitur për këtë qëllim sipas shtojcës nr. 1 bashkëlidhur vendimit.

Në pikën pesë, parashikohen rastet e nevojës për të sqaruar dhe vendosur në lidhjen me klasifikimin e çështjeve të caktuara që në pamje të para konsiderohen nga nëpunësi civil gjyqësor me natyrë të dyzuar. Nëse ka dyshime në lidhje me kategorinë apo nënkategorinë në të cilën çështja duhet të klasifikohet, kancelari është ai që orienton klasifikimin e çështjes, pas miratimit nga gjyqtari relator i çështjes, ose me urdhër dhe porosi të këtij të fundit.

Në pikën gjashtë, parashikohet se është Këshilli i Gjykatës organi që miraton listën e llojit të çështjes civile, penale e administrative sipas kategorive kryesore si dhe listën e përshkrimit të çështjes sipas nënkategorive kryesore, me qëllim grupimin e tyre, duke u bazuar në listën në shtojcën nr. 2 të këtij vendimi. Kjo listë pasqyrohet edhe në bazën e të dhënave të krijuar dhe që do të përdoret për qëllimet e këtij procesi nga gjykatat.

Në pikën shtatë pasqyrohet praktika e mirë e informimit të Këshillit të Lartë Gjyqësor si organi fundor e kryesor përgjegjës për mbarëvajtjen dhe miradministrimin e sistemit gjyqësor. Sipas këtij neni gjykatat përgatisin raportin mujor mbi numrin e çështjeve të analizuara dhe klasifikuara në bazën e të dhënave për çështjet e prapambetura, dhe ia dërgojnë atë Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Në pikën tetë janë parashikuar dispozita tranzitore, për fillimin e procesit dhe parashikimet për përfundimet e tij.

Duke marrë në koherencë kohën në të cilën janë bërë diskutimet në grupin e punës, kjo është paraqitur me dy variante. Një variant ka qenë: “Gjykata përfundon procesin e analizimit dhe klasifikimit të çështjeve të prapambetura brenda dy muajve nga hyrja në fuqi e këtij vendimi.”. Ndërsa varianti i dytë ka qenë: “Gjykata përfundon procesin e analizimit dhe klasifikimit të çështjeve të prapambetura brenda tre muajve nga hyrja në fuqi e këtij vendimi.”.

Por duke marrë në konsideratë kohën në të cilën po shqyrtohet ky akt dhe njëkohësisht dhe urgjencën për t'u miratuar dhe për t'u vënë në funksionim, atëherë si relator do të propozoja për variantin e parë: "Gjykata përfundon procesin e analizimit dhe klasifikimit të çështjeve të prapambetura brenda dy muajve nga hyrja në fuqi e këtij vendimi."

Në nenin nëntë parashikohen zyrat përkatëse për vënien në jetë të procesit dhe marrjen e masave të nevojshme për zbatimin e udhëzimit.

Në fund, projekt-udhëzimi parashikohen rregulla për hyrjen në fuqi të këtij udhëzimi.

Në lidhje me zbatimin e aktit-

Rregullat e këtij projekt-udhëzimi janë të zbatueshme nga gjykata e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm dhe Gjykata Administrative e Apelit, gjykata të cilat shfaqin problematikën më të madhe për sa i përket numrit të çështjeve të prapambetura. Zbatimi i këtij akti kërkon angazhimin e plotë të të gjitha strukturave të gjykatës si dhe bashkëpunim të ngushtë me KLGJ-në. Mbarëvajtja e procesit do të sigurohet përmes një procesi raportimi në Këshill në mënyrë periodike, si një mekanizëm monitorimi dhe analizimi të shkallës së zbatimit dhe respektimit të rregullave të këtij Udhëzuesi.

Për sa i përket efekteve financiare të aktit -

Zbatimi i këtij akti nuk sjell pasoja financiare për buxhetin e Këshillit apo të gjykatave, megjithatë, në të ardhmen mund të lindë nevoja e zhvillimit të aktiviteteve të caktuara, tryeza diskutimi apo trajnime, çka mund të sjellë kosto financiare në të ardhmen. Kostimi i këtyre aktiviteteve mund të merret në konsideratë në bashkëpunim e me ndihmën e donatorëve dhe partnerëve vendas dhe ndërkombëtarë që mbështesin veprimtarinë e Këshillit.

Pra në pikën 8 kishte dy variante, duke marrë në konsideratë kohën në të cilën është diskutuar dhe hartuar ky projekt-udhëzim në grupin e punës. Meqenëse është një kohë rreth dy muaj nga momenti i miratimit deri më sot, duke pasur në konsideratë që hartimi i strategjisë parashikon marrjen e masave sa më të shpejta, s'po them urgjente, por duhet thënë edhe fjala urgjente, atëherë propozoj që të jetë varianti i parë "Gjykata

përfundon procesin e analizimit dhe klasifikimit të çështjeve të prapambetura brenda dy muajve nga hyrja në fuqi e këtij vendimi.”, për të qenë në koherencë me qëllimin për të cilin po miratohen këto akte.

Naureda Llagami: Atëherë, faleminderit!

Po!

Klodian Kurushi: Vetëm një diskutim të vogël.

Doja thjesht ndoshta për t’u qartësuar më mirë, mendoj unë, tek projekt-udhëzimi, pika 3, germa “a”. (lexon)

“Nëpunësi civil gjyqësor në verifikimin e elementeve formale të dosjes gjyqësore përfshin këto veprime: a) "Verifikohet nëse në dosjen gjyqësore janë administruar fashikulli i gjykimit të kryer në shkallë të parë si dhe fashikulli i gjykimit të krijuar në gjykatën e apelit dhe Gjykatën e Lartë...”.

Unë do propozoja: "Verifikohet nëse në dosjen gjyqësore është (jo janë, se i referohet fashikullit) administruar fashikulli”, për të vijuar më tej “i gjykimit të krijuar”, duhet të jetë, propozoj “fashikulli i gjykimit i krijuar në gjykatën e shkallës së parë”, se ndiqet e njëjta terminologji, siç është “fashikull i gjykimit i krijuar në gjykatën e apelit”, “fashikulli i gjykimit i krijuar në Gjykatën e Lartë”, mendoj duhet të shtohet “fashikulli i gjykimit (të hiqet fjala “të kryer”) i krijuar”, të shtohet fjala “gjykatën e shkallës së parë, pra në gjykatën e shkallës së parë”, si dhe vijon më tej “fashikulli i gjykimit i krijuar në gjykatën e apelit”, pra nga “të krijuar – i krijuar në gjykatën e apelit dhe Gjykatën e Lartë”. Vetëm thjesht për terminologji. E njëjta është.

Naureda Llagami: Ok! Shumë dakord.

Atëherë mund ta riformulojmë edhe një herë sipas propozimit të z. Kurushi. Ndonjë merak tjetër?

E reflektojmë në zbardhje këtë gjë. Nuk ka nevojë t’i ripërsërisim se këto gjëra reflektohen tek zbardhja, se është çështje teknike legjislative, nuk ka lidhje me çështjen e

idesë dhe me thelbin.

Nëse s'kemi gjë, kalojmë në miratimin e projekt-udhëzimit?

Ilir Rusi: Dakord.

Irena Plaku: Pro.

Gentiana Muçaj: Dakord.

Ridvan Hado: Dakord.

Alban Toro: Dakord.

Fatmira Luli: Dakord.

Markelian Koça: Dakord.

Yllka Rupa: Pro.

Emona Muçi: Dakord.

Klodian Kurushi: Dakord.

Naureda Llagami: Dakord.

Atëherë projekt-udhëzimi miratohet sipas propozimit të ardhur nga grupi i punës, me sugjerimet e bëra nga z. Kurushi.

* * *

(Pika 3 e rendit të ditës)

Për Këshillin e Lartë Gjyqësor



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____.____.2024

PROCESVERBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR

(Mbledhje e realizuar me video konferencë)

(Mbajtur, më 09.05.2024)

Pika 4 e rendit të ditës me objekt: Shqyrtimi i projektvendimit “Për disa shtesa dhe ndryshime në vendimin nr.78, datë 30.05.20219 të Këshillit të Lartë Gjyqësor "Për kalendarin e shqyrtimit të çështjeve në Gjykatën e Apelit”, përgatitur nga Grupi i Punës "Për hartimin e strategjisë për uljen e numrit të çështjeve të prapambetura në gjykata (anëtarët z. Ilir Rusi, z. Ridvan Hado dhe znj. Irena Plaku).

Drejton mbledhjen Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, zonja Naureda Llagami.

Mbledhja u zhvillua në sallën e mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 11:10 dhe mbaroi në orën 13:48.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

- | | |
|----------------------------------|---------------------------------|
| <i>1. Naureda Llagami</i> | <i>(kryetare)</i> |
| <i>2. Ilir Rusi</i> | <i>(zëvendëskryetar)</i> |
| <i>3. Klodian Kurushi</i> | <i>(anëtar)</i> |
| <i>4. Fatmira Luli</i> | <i>(anëtare)</i> |
| <i>5. Irena Plaku</i> | <i>(anëtare)</i> |
| <i>6. Gentiana Muçaj</i> | <i>(anëtare)</i> |
| <i>7. Ridvan Hado</i> | <i>(anëtar)</i> |

- | | |
|--------------------------|------------------|
| <i>8. Alban Toro</i> | <i>(anëtar)</i> |
| <i>9. Markelian Koça</i> | <i>(anëtar)</i> |
| <i>10. Yllka Rupa</i> | <i>(anëtare)</i> |
| <i>11. Emona Muçi</i> | <i>(anëtare)</i> |

Morën pjesë gjithashtu nëpërmjet platformës dhe në sallë:

- 1. Rudin Baqli, Sekretar i Përgjithshëm.*
- 2. Blerta Ngucaj, Drejtore e Departamentit të Shërbimeve Juridike dhe Marrëdhënieve me Jashtë.*
- 3. Luan Dibra, Rezarta Taushani, Gentiana Agushi, Këshilltarë pranë Komisioneve të Përhershme në Këshill.*
- 4. Denisa Varfi dhe Entela Dobi, përfaqësuese të Ministrisë së Drejtësisë.*
- 5. Arturo Valdes dhe Arben Lila, përfaqësues të Projektit EU4Justice. (në sallë)*
- 6. Olta Lolo dhe Valbona Bala, përfaqësuese të EWMI/INL. (në sallë)*
- 7. Sidorela Driçi, AIS Instituti Shqiptar i Shkencës (prezent në një pjesë të mbledhjes).*
- 8. Staf nga administrata e KLGJ-së.*

RENDI I DITËS:

4. Shqyrtimi i projektvendimit “Për disa shtesa dhe ndryshime në vendimin nr.78, datë 30.05.20219 të Këshillit të Lartë Gjyqësor "Për kalendarin e shqyrtimit të çështjeve në Gjykatën e Apelit”, përgatitur nga Grupi i Punës "Për hartimin e strategjisë për uljen e numrit të çështjeve të prapambetura në gjykata (anëtarët z. Ilir Rusi, z. Ridvan Hado dhe znj. Irena Plaku).

Naureda Llagami: Kalojmë tek projekt-akti i fundit në paketën e projekt-akteve që lidhen me strategjinë për uljen e backlog-ut, që ka të bëjë me disa ndryshime në vendimin e Këshillit të Lartë Gjyqësor nr.78, datë 30.05.20219 "Për kalendarin e shqyrtimit të çështjeve në Gjykatën e Apelit”.

Për më shumë detaje edhe për këtë akt fjalën ia jap z. Rusi i cili shkurtimisht do shpjegojë ku konsistojnë ndryshimet e propozuara nga grupi i punës?

Ilir Rusi: Faleminderit e nderuar Kryetare!

Doja të vija theksin jo në falënderime, por në besimin që autoritetet përkatëse na dhanë për të qenë pjesë e këtij grupi pune.

Për të qenë sintetik dhe konkret, po kalojmë tek propozimet konkrete të cilat kemi propozuar për të ndryshuar vendimin nr. 78, datë 30.05.2019 "Për kalendarin e shqyrtimit të çështjeve në Gjykatën e Apelit". Edhe këtë e kemi paraqitur në dy pika me dy variante, në koherencë të diskutimeve të kohës të bërë në grupin e punës.

Në pikën 1 të Kreut I bëhen shtesat dhe ndryshime:

Një variant është: Në fund të fjalisë së parë shtohet "...ose listën e grupçështjeve të caktuara në përjashtim të radhës sipas vendimit të Këshillit të Gjykatës."

Ndërsa varianti i dytë është: Në fund të fjalisë së parë shtohet "...ose grupçështjet e caktuara në përjashtimin e radhës sipas vendimit të Këshillit të Gjykatës."

Pas pikës 1 shtohet pika 1/1 (dhe ky është një variant) më këtë formulim: "1/1 Listat e shqyrtimit të grupçështjeve të caktuara në përjashtim të rregullit të shqyrtimit sipas kohës së regjistrimit të tyre, me qëllim përmirësimin e shpejtësisë dhe të efektivitetit të gjykimeve dhe uljes së çështjeve të prapambetura, hartohen nga Këshilli i Gjykatës pasi të jetë marrë mendimi i mbledhjes së përgjithshme të gjyqtarëve, sipas rregullave të përcaktuara në këtë vendim."

Ndërsa varianti i dytë në lidhje me këtë është që të shtohet pika 1/1 më këtë përmbajtje: "1/1 Grupçështjet e caktuara në përjashtim të rregullit të shqyrtimit sipas kohës së regjistrimit të tyre, me qëllim përmirësimin e shpejtësisë dhe të efektivitetit të gjykimeve dhe uljes së çështjeve të prapambetura, hartohen nga Këshilli i Gjykatës pasi të jetë marrë mendimi i mbledhjes së përgjithshme të gjyqtarëve, sipas rregullave të ..."

Naureda Llagami: Meqë kemi edhe gjyqtarë të apelit këtu. Pra ajo që propozohet nga grupi i punës është prioritizimi i çështjeve, dhe kemi "prioritizimin e listës së

grupçështjeve të caktuara me përjashtim të radhës”, - është njëri variant, dhe varianti tjetër është “prioritizimi i grupçështjeve të caktuara me përjashtim të radhës”. Pra kemi të bëjmë vetëm me terminologji.

Ju si gjyqtarë apeli apo gjyqtarë karriere me 30 vjet, çfarë mendimi keni?

Emona Muçi: Si gjyqtare apeli jam për “grupçështje”. Por varet, kjo vendimmarrje e jona do të ndikojë edhe tek pikat e tjera. Kjo duhet mbajtur në vëmendje.

(Disa nga anëtarët komunikojnë pa ndezur mikrofonat.)

Naureda Llagami: Flisni me mikrofon dhe më thoni ku e keni merakun, duke qenë se kemi dy propozime, dhe ky akt është për apelin. Pra jeni me qëndrimin që duhet të jetë “listë e grupçështjeve” apo mjafton togfjalëshi “grupçështje”.

Ridvan, ti je gjyqtar apeli, Emona është gjyqtare apeli, ndajeni ju të dy, duke qenë se edhe grupi i punës ka qenë në dilemë.

Të lutem, shtype butonin dhe fol me buton.

Emona Muçi: Një pyetje grupit të punës.

Çfarë keni mbajtur në vëmendje kur keni përcaktuar terminologjinë “listën e grupçështjeve” dhe vetëm “grupçështjeve”?

Ilir Rusi: Lista ka të bëjë në rastin kur zbatohet inventarizimi, grupohen çështjet sipas kategorive dhe bëhet një listë, një kronologji e tyre. Ndërsa “grupçështje” është pa ekzistencën e një liste kronologjike të numrit të çështjeve, ti përthith grupin e çështjeve.

Irena Plaku: Kjo do bëhet edhe sipas radhës.

Ilir Rusi: Kush kjo?

Irena Plaku: Renditja.

Ilir Rusi: Renditja pra. Kur ke listë, ke renditje të çështjeve. Pra ke grupçështje, por ke 100 çështje dhe i ke nga numri 1 deri tek 100. Kurse kur ke grupçështjesh, ti përthith nga grupçështjet një çështje. Kjo është diferenca ndërmjet listës së grupçështjeve, ku ke për një çështje të caktuar ke 100 raste dhe ti ke një radhë kronologjike të tyre nga i pari deri tek i fundit, dhe grupçështjeve ku ke grupin e çështjeve, pa inventarizuar sa ke ato dhe përthith një prej tyre për të vazhduar më tej me prioritet. Kjo është diferenca.

Emona Muçi: Ky projektvendimi a do jetë bashkekzistues edhe me strategjinë, që pas inventarizimit secila prej gjykatave do të ketë listën e çështjeve, pra duhet ta bëjë listën e çështjeve, që do të thotë, edhe në rastin kur ty të mungon efektivisht lista, ti e ke listën, sepse e ke tek projektvendimi për strategjinë (tek pika tjetër që ne miratuum). A do bëjmë neve një listim të të gjitha çështjeve, një inventarizim të tyre?

Ilir Rusi: Këtë po ju them.

Edhe çështjet e sotme për t'u diskutuar dhe miratuar në këtë mbledhje plenare, renditja e tyre nuk është rastësore. Është strategjia, numri i gjyqtarëve, inventarizimi (që sapo miratuum) dhe pas kësaj vjen prioriteti apo kronologjia e gjykimit të çështjeve.

Kur themi “listë të grupçështjeve”, do të thotë edhe një herë, në vetveten e vet kemi renditur çështje sipas vjetërsisë së tyre por në raport me tipologjinë dhe llojin e tyre, dhe kemi 100 çështje të kësaj natyre, sipas vjetërsisë; kurse kur themi “grupçështje”, do të thotë që mes tyre ato nuk renditen sipas vjetërsisë, por ndërmjet tyre relatori vlerëson për të gjykuar një çështje në një moment kohor, pavarësisht vjetërsisë që janë çështjet tek ky grupi i çështjeve. Kurse kur kemi listë ato renditen sipas kohës së regjistrimit të tyre, pra vjetërsisë së tyre. Lista e grupçështjeve krijon dy komponentë, krijon komponentin e grupçështjes së llojit të saj dhe vjetërsinë e tyre të regjistrimit apo të mosgjykimit. Ndërsa tek grupçështjet nuk kemi një renditje të vjetërsisë së tyre, të regjistrimit apo të mosgjykimit, por kemi vetëm llojin, tipologjinë e tyre të grupuara. Relatori në këtë rast

ndodhet në dy situata. Nëse do kemi “listë të grupçështjesh”, do marrë të parën, të tetën apo të njëqindën dhe pse; ndërsa kur kemi “grupçështje”, përthith një prej tyre dhe është në rregull me aktin. Kjo është filozofia.

Emona Muçi: Më fal, kam edhe unë përshtypjen se neve në qoftë se miratojmë aktin, nuk e miratojmë kot dhe ne përderisa marrim përsipër të bëjmë inventarizimin dhe listimin e të gjitha çështjeve që janë në gjykatë, kjo duhet të mbahet në vëmendje nga secili prej gjyqtarëve. Kështu që, tani të biem dakord të kemi një listë apo dy-tre lista për çdo akt. Unë mendoj, unë jam partizane që të ketë një listë dhe gjyqtarët janë të detyruar për të ecur sipas inventarizimit dhe listimit të një akti të më përparshëm. Po i shtuam edhe një listë tjetër, ato do thonë, kë do zbatoj, këtë apo atë pastaj. Kjo është ideja. Ne zgjedhim vetë atë mënyrën e qasjes se si t’jua lehtësojmë punën atyre që do ta marrin, dhe për rezultatin dhe suksesin në punë. Kjo është. Unë them, që pa përcaktuar listat, gjyqtarët e kanë parasysh inventarizimin e listës, gjyqtarët janë më fleksibël që në qoftë se kemi, domethënë edhe vitin që vjen, për shembull ky vit aktual, në qoftë se ato do duan, do të heqin ose do të evadojnë një lloj çështjeje, gjithë treshja për shembull. Pra ata do të jenë më fleksibël për të futur edhe çështje të reja të themi tek ajo lista, për t’i hequr. Sepse mund të mbahet i njëjti qëndrim për një çështje të caktuar, pra të konsolidohet qëndrimi.

Naureda Llagami: Çfarë propozon konkretisht, variantin 1 apo variantin 2?

Klodian Kurushi: Atëherë, unë mendoj, ndërmjet dy alternativave, lista do ishte më e përshtatshme, sepse i vendos gjyqtarët përpara një sigurie, pa hapur debate të mëtejshme dhe diskutime mes gjyqtarëve “jo e përzgjedhe ti nga ky grupi i çështjeve një çështje që mund të jetë e fundit e regjistruar, por ti e nxore përpara në gjykim”, për ta lënë gjyqtarin të qetë dhe në këtë pjesë. Nëse bëhet mbi bazën e listës, e merr, edhe qytetarët janë të sigurt, sepse i dinë prioritetet e tyre se kush çështje do gjykohet më përpara, edhe gjykata nuk do atakohet, dhe gjyqtari nuk do atakohet në këtë pikë për të

nxjerrë diskutime që të thonë, ti e ke përzgjedhur përpara.

Emona Muçi: Jam shumë dakord për këtë. Unë mbaj në vëmendje, një rend më përpara ne kemi miratuar inventarizimin. Pra ne nxorëm lista dhe aty do të fokusohemi, tek ato lista. Kjo ishte ideja ime. Nuk është se mungon lista. Patjetër që do i referohemi listave.

Irena Plaku: Për sa i përket inventarizimit, është tjetër gjë. Gjykatat duhet të kenë një inventar të çështjeve. Grupimi më pas, domethënë pasi të bëhet inventarizimi do bëhet ky grupim. Domethënë do ndahen çështjet sipas këtyre kategorive të cilat janë përcaktuar në vendimin e Këshillit të Lartë Gjyqësor, ku është propozuar edhe shtimi i një grup të çështjeve, këto çështje të cilat do grupohen, do vihen në listë sipas vjetërsisë, do listohen me pak fjalë.

Prandaj është përmendur termi listë, se do listohen me pak fjalë.

Naureda Llagami: Kemi më për të sqaruar mbi projekt-aktin?

Vazhdo! Pjesën e listës dhe këtë e kalojmë në votim pastaj, kush është për “listë” dhe kush është për “grupçështje”.

Edhe një herë fjalën e ka Iliri, shkurtimisht.

Për “listën” dhe për “grupçështjet”, doni ta ndajmë me vendim tani apo dakordësohemi të gjithë me një qëndrim?

Unë do propozoja gjyqtarët e apelit, meqë janë gjyqtarë të asaj gjykate, të vlerësojnë; dhe Gjykata e Lartë.

E hedhim në votim me “listë” pra? Jemi dakord?

Propozimi i parë.

Ilir Rusi: Dakord Iliri me listë.

Irena Plaku: Pro.

Gentiana Muçaj: Dakord.

Ridvan Hado: Dakord.

Alban Toro: Dakord.

Fatmira Luli: Dakord.

Markelian Koça: Dakord.

Yllka Rupa: Pro.

Emona Muçi: Dakord.

Klodian Kurushi: Dakord.

Naureda Llagami: Dakord.

Kalojmë tek varianti me “listë”.

Naureda Llagami: Tani Ilir, na sqaro çështjet e tjera.

Ilir Rusi: Pas pikës 1 shtohet pika 1/1. Në terminologji do qëndrojë terminologjia “Lista e shqyrtimit të grupçështjeve të caktuara në përjashtim të rregullit të shqyrtimit sipas kohës së regjistrimit të tyre, me qëllim përmirësimin e shpejtësisë dhe të efektivitetit të gjykimeve dhe uljes së çështjeve të prapambetura, të hartohen nga Këshilli i Gjykatës pasi të jetë marrë mendimi i mbledhjes së përgjithshme të gjyqtarëve, sipas rregullave të përcaktuara në këtë vendim.”

Ndërsa varianti i dytë, por meqenëse tani terminologjia është “listë”, është vetëm ndryshimi i faktit që ky vendim që merr i njoftohet menjëherë Këshillit të Lartë Gjyqësor, i cili shprehet brenda 3 ditëve për pranimin ose jo.

Pra ajo që është për diskutim është fakti që “do hartohen nga Këshilli i Gjykatës pasi të jetë marrë mendimi i mbledhjes së përgjithshme të gjyqtarëve, sipas rregullave të përcaktuara në këtë vendim”, apo që “lista e grupçështjeve të caktuara në përjashtim të rregullit të shqyrtimit sipas kohës së regjistrimit të tyre, me qëllim përmirësimin e shpejtësisë dhe të efektivitetit të gjykimeve ..., hartohen nga Këshilli i Gjykatës pasi të jetë marrë mendimi i mbledhjes së përgjithshme të gjyqtarëve, sipas rregullave të përcaktuara në këtë vendim. Ky vendim i njoftohet menjëherë Këshillit të Lartë Gjyqësor, i cili shprehet brenda 3 ditëve nga pranimi i saj.

Pra varianti i dytë është nëse kjo listë do t’i njoftohet Këshillit të Lartë Gjyqësor i

cili do shprehet brenda tre ditëve apo (*varianti i parë*) do ezaurohet vetëm me vendimin e Këshillit të Gjykatës pasi të jetë bërë mbledhja e përgjithshme e gjyqtarëve.

Naureda Llagami: Këtë praktikë e ndjekin edhe Gjykata e Lartë? Na njofton neve kur bën këto listat?

Publikim bën edhe apeli, por a na njofton neve me shkrim? Të kemi të njëjtin standard. Këtë kam merak unë.

Po, zoti Kurushi!

Klodian Kurushi: Kam vetëm një propozim, që këto shprehjet që u diskutuan tani të hiqen fare nga propozimi përkatës. Pra edhe njoftimi edhe shprehja e KLGJ-së pas njoftimit, të hiqen fare. Nuk janë të nevojshme. Detyrimi është i Këshillit të Gjykatës që të marri përsipër të bëjë listat përkatëse dhe të respektojë listat që i vendosin vetë, i përgatisin vetë. Ky është propozimi im.

Naureda Llagami: Pas propozimit të zotit Kurushi?

Ilir Rusi: Atëherë, sipas propozimit të z. Kurushi, evidentohet fakti që të jetë varianti i parë, pra pas pikës 1 të shtohet pika 1/1 më këtë përmbajtje: ”1/1 Listat e shqyrtimit të grupçështjeve të caktuara në përjashtim të rregullit të shqyrtimit sipas kohës së regjistrimit të tyre, me qëllim përmirësimin e shpejtësisë dhe të efektivitetit të gjykimeve dhe uljes së çështjeve të prapambetura, hartohen nga Këshilli i Gjykatës pasi të jetë marrë mendimi i mbledhjes së përgjithshme të gjyqtarëve, sipas rregullave të përcaktuara në këtë vendim.”

Naureda Llagami: Kemi më?

Ilir Rusi: Në kreun e dytë bëhen këto shtesa dhe ndryshime.

Titulli i Kreut II ndryshohet në “Rastet e përshpejtimit të çështjeve”.

Në nenin 1, në togfjalëshin e fjalisë së parë “mund të përshpejtohet vetëm mbi kërkesë të palëve”, hiqet termi “vetëm”. Ky është një variant i parë i përcjellë. Kurse një variant i dytë është “... ose në përputhje me listën e grupçështjeve të caktuara në përjashtim të radhës sipas vendimit të Këshillit të Gjykatës.”.

Pra diskutimi këtu është, të hiqet vetëm fjala “vetëm”, “mund të përshpejtohet mbi kërkesën e palëve”, ndërsa një variant i dytë është “... ose në përputhje me listën e grupçështjeve të caktuara në përjashtim të radhës sipas vendimit të Këshillit të Gjykatës.”. Ky është diskutimi.

Naureda Llagami: Sqaroheni mirë, sepse nuk kuptoheni kur e thoni.

Ky është problemi me juve.

Juve e keni të qartë se keni ndenjur 8 muaj duke diskutuar dhe na e thoni neve sikur ne jemi bashkë me ju tek 8-muajshi, ndërkohë që s’jemi ne aty. Kështu që ka mundësi ta kuptojmë ku është synimi dhe diferencat, meqë na i keni sjellë?

Ilir Rusi: Nëse do lejme variantin e parë, “mund të përshpejtohet vetëm mbi kërkesën e palëve” (ndërpritet audio).

Naureda Llagami: Sqaroje ku është ndryshimi i kësaj. Ku ndryshon nga si ka qenë dikur. Ku është propozimi një? Ku është propozimi dy?

Ilir Rusi: Aktualisht është “me kërkesë të palëve”.

Një variant është të hiqet fjala “vetëm”.

Aktualisht është “mund të përjashtohet vetëm me kërkesë të palëve”.

Një propozim është që të hiqet fjala “vetëm”, “mund të përjashtohet mbi kërkesën e palëve”.

Propozimi tjetër është që në fund të fjalisë... pra të shprehemi pas kësaj “mund të përjashtohet mbi kërkesën e palëve”, “...ose në përputhje me listën e grupçështjeve të caktuara në përjashtim të radhës sipas vendimit të Këshillit të Gjykatës.”, - që do të thotë,

aktualitetin sot e kemi “vetëm me kërkesë të palëve” (një variant). Nëse ne do heqim fjalën “vetëm”...

Pra do të thotë ose me kërkesë të palëve mund të vlerësojë, ose sipas listës së grupçështjeve.

Klodian Kurushi: Atëherë, siç e kuptoj unë.

Këtu është një vendim në të cilin propozohen disa ndryshime për përshpejtimin e çështjeve për të gjykuar në gjykatën e apelit. Deri tani, kuadri ekzistues është që përshpejtimi i çështjeve të bëhet vetëm me kërkesë të palëve. Ndryshimet e reja sjellin dy alternativa: e para, me kërkesë të palëve (siç është) dhe do hiqet “vetëm”, pra me kërkesë të palëve, dhe alternativa e dyta është që nuk janë vetëm palët ata që bëjnë kërkesë për përshpejtimin por është edhe lista e miratuar nga Këshilli. Alternativa me kërkesë të palëve, ekziston, nuk është se s’ekziston. Por mund të përdoret edhe lista.

Naureda Llagami: Atëherë, në teknikë legislative po the “vetëm mbi kërkesë” dhe “ose në përputhje”, do të thotë që ti ngelesh vetëm tek kërkesa, pra fjala “vetëm” do hiqet në të dy situatat. E dyta, në qoftë se do jetë opsionale “me kërkesë të palëve” “dhe/ose në përputhje me”, e vë edhe “dhe” se mund të jetë ndoshta edhe me kërkesë dhe/ose...

Pra e para, do heqim “vetëm” dhe do shtojmë “... ose në përputhje [...]”. Pra nuk është as varianti 1, as varianti 2, por është varianti 3 që e themi ne këtu.

Pra propozimi do jetë që tek kreu II, në nenin 1, të hiqet fjala “vetëm” dhe të shtohet fjalia “... ose në përputhje me listën e grupçështjeve të caktuara në përjashtim të radhës sipas vendimit të Këshillit të Gjykatës.”. Ok? Jemi dakord me këtë variant?

Dakord!

Naureda Llagami: Kalojmë tek sqarimi i pikës tjetër.

Ilir Rusi: Në nenin 2, fjalia e parë ndryshohet si vijon: “Gjyqtari relator cakton

datën në përputhje me kalendarin e tij të shqyrtimit të çështjeve duke mbajtur parasysh kërkesat për shpejtim apo listën e grupçështjeve të miratuara nga Këshilli i Lartë Gjyqësor”. Po (*korrigjohet*) “të miratuara nga Këshilli i Gjykatës.”

“Gjyqtari relator cakton datën në përputhje me kalendarin e tij të shqyrtimit të çështjeve duke mbajtur parasysh kërkesat për shpejtim ose listën e grupçështjeve të miratuara nga Këshilli i Gjykatës.”, -po e themi “ose”, me idenë që ne të ndjekim në vijueshmëri terminologjinë që po diskutojmë dhe miratojmë në vijueshmëri të këtij akti.

Naureda Llagami: Dakord. Kjo është Ok.

Pjesa tjetër? Pika 5.

Ilir Rusi: Në pikën “e”, në fund të fjalisë shtohet “apo pezullimin e gjykimit”. Tek pika “e”.

Irena Plaku: Janë listat.

Naureda Llagami: Janë listat. Po mirë pra, sqaroje! Çfarë keni shtuar ju me listat plus, që s’i keni pas më përpara?

Ilir Rusi: Tek pika 3.1, pika 3 (*lapsus, pasi e ka fjalën për pikën “e”*), në fund të shtohet fjala “apo pezullimin e gjykimit”.

Naureda Llagami: Mirë pra Ilir, duhet me e thënë që në listën ezauruese të pikës 3, që kemi çështje që kanë objekt “kështu, kështu”, do shtohet edhe “me pezullim gjykimi”. Vetëm kjo shtohet apo ka edhe të tjera?

Ke dy. Atëherë, në pikën 3.1... (*konsultohen me aktin*)

Ilir, po flet pa mikrofon.

Ilir Rusi: Atëherë, meqenëse isha pa mikrofon.

Tek 3.1, pika “e”, në fund të shtohet “apo pezullimin e gjykimit”.

Naureda Llagami: Relatoje pak më mirë pjesën e grupçështjeve që ne synojmë t'i kalojmë me përshpejtim sipas grupçështjeve.

Ilir Rusi: Duke vlerësuar përmbajtjen e vendimit 78, frymën dhe qëllimin e tij, tani tek pika 3.1, “g” do ndryshohet: “g. çështjet me objekt vërtetim fakti juridik i vjetërsisë në punë ose njohjen e vërtetësisë apo pavërtetësisë së dokumentit me pasoja juridike sa i përket përfitimit të pensionit si dhe çdo çështje me pasoja juridike për përfitimin e pensionit.”. Në këtë format do ndryshohet kjo. Ndryshohet, thashë, ndryshohet.

Pika “gj” do ndryshohet me këtë formulim sipas propozimit tonë: “gj. çështjet me objekt zgjidhjen e mosmarrëveshjeve nga marrëdhënia e punës apo ato që rrjedhin nga shpërblimi i dëmit nga zgjidhja e marrëdhënies së punës.”.

Pika “i” të ndryshohet në këtë format: “i. çështjet në të cilat pala ka paraqitur ankim jashtë afatit, kundër një vendimi ndaj të cilit nuk lejohet ankim apo nga një person që nuk legjitimohet të bëjë ankim.”.

Deri më këtu kishim formulime të cilat ekzistojnë tek akti 78, por do ndryshohen me këtë lloj përmbajtje të cilat sapo i përmendëm në mënyrë eksplicite.

Pikat e tjera në objekt të kësaj, pikat që shtohen është: pika “m”, “n”, “nj”, “o”, “p” dhe “q”.

Pika “m” të jetë me këtë lloj përmbajtje: “m. çështjet që përfitojnë nga amnistia sipas ligjit përkatës.”.

Shtohet pika “n”: “n. vendimet e ndërmjetme me objekt sigurim padie apo pjesëtim pasurie faza e parë.”.

Pika “nj”: “nj. gjykimi i kërkesave për konstatimin e shkeljes së afatit të arsyeshëm, përshpejtimin e procedurave dhe shpërblimin e demit.”.

Pika “o” të shtohet: “o. çështjet për cilat padia nuk e kalon vlerën e 150.000 (njëqind e pesëdhjetë mijë) lekëve.”.

Pika “p” të shtohet: “p. çështjet me objekt strehimin social.”.

Pika “q” të shtohet: “q. çështjet që kanë me objekt të drejtat e personave me aftësi të kufizuar.”.

Nëse më lejoni për të bërë një perifrazim të ndryshimit të pikës 3 që i përket Kreut 2 të aktit aktual, ne kemi paraqitur të shtohet edhe një fjalë përkatëse, siç ishte ajo “apo pezullimin e gjykimit”. Pikat “g”, “gj”, “i”, të ndryshohen sipas formulimit që unë i përmenda në mënyrë verbale dhe të regjistruar tashmë, dhe tek kjo nënpikë të shtohen pikat “m”, “n”, “nj”, “o”, “p”, “q”, sipas përmbajtjes që unë i përmenda dhe ju i keni në dispozicion projekt-aktin përkatës.

Naureda Llagami: Unë jam kundër. Ky nen me teknikë legjislative kërkon komplet ndryshimin e pikës 3. Për sa kohë neni ka ndryshuar mbi 50% të vetes, atëherë kemi një ndryshim të nenit të ri.

Dhe unë them, për ta pas më të thjeshtë edhe kur ta zbardhim këtë gjë, të themi që pika 3.1 ndryshohet duke u formuluar edhe një herë si më poshtë. Dhe merrni dhe ndryshohet, katër pikat e para janë të pandryshueshme, të gjithë pikat e tjera shtohen. Kështu e kemi edhe më të qartë ne, e ka më të qartë gjyqësori dhe kush na dëgjon të gjithë pastaj.

Kalojmë tek çështja tjetër, tek pika tjetër e fundit, neni 7.

Pra vetëm për teknikë legjislative, përmbajtja është e njëjtë, por të ndryshohet, të mos themi edhe “të shtohen” dhe “të ndryshohen” nënpikat, por të themi vetëm që “Neni 3.1 i vendimit 78 të riformulohet si më poshtë”, dhe vjen riformulimi që ju keni thënë.

Kalojmë tek pika 7.

Ilir Rusi: Në fund të pikës 3.1 shtohet një fjali me këtë përmbajtje: “Këshilli i Gjykatës, me propozim të Mbledhjes së Përgjithshme të Gjyqtarëve, mund të hartojë, tashmë ne kemi përmendur “grupçështje”, por e kemi “listën e grupçështjeve” për shkak të reflektimit të terminologjisë së miratuar përgjatë shqyrtimit të këtij akti, përtej kritereve të mësipërme me qëllim mbrojtjen e interesit publik, përmirësimin e shpejtësisë

dhe efektivitetit të gjykimit dhe miradministrimin e drejtësisë. Vendimi i Këshillit të Gjykatës i përcillet menjëherë për dijeni Këshillit të Lartë Gjyqësor.”. Por meqenëse ne ramë dakord tek ndryshimet e mëparshme që kjo mos t’i përcillet Këshillit, atëherë në këtë moment do ketë një ndryshim terminologjie, jo “grupçështje” por “listën e grupçështjeve” dhe fjalia e fundit “Vendimi i Këshillit të Gjykatës i përcillet menjëherë për dijeni Këshillit ...”, të mos jetë pjesë integrale e këtij formulimi.

Naureda Llagami: Dakord.

Ilir Rusi: Dhe nëse do më lejoni për ta perifrazuar, do të jetë: ...

Naureda Llagami: Mos e perifrazo! Vazhdo Ilir tek tjetra!

Kalo tek tjetra, tek pika 3.

Ilir Rusi: Në Kreun IV bëhen shtesat dhe ndryshimet e mëposhtme:

Pas pikës 3 shtohen dy pika me këtë përmbajtje:

“4. Në përfundim të procesit të analizimit dhe klasifikimit të çështjeve të prapambetura, Këshilli i Gjykatës merr masa për krijimin e listave të grupçështjeve sipas pikës 1.1 të këtij vendimi dhe ia përcjell ato menjëherë gjyqtarëve, ndihmësve ligjorë të caktuar dhe për dijeni edhe Këshillit të Lartë Gjyqësor.” - “...për dijeni edhe Këshillit të Lartë Gjyqësor”, me koherencë do e heqim.

5. Këshilli i Gjykatës raporton çdo 3 muaj për ecurinë e shqyrtimit të çështjeve të prapambetura sipas listave të grupçështjeve sipas formatit të raportimit bashkëlidhur këtij vendimi.”

Naureda Llagami: Ku raporton?

Ilir Rusi: Në Këshill.

Naureda Llagami: Këshilli i Gjykatës, tek Këshilli i vet?

Ilir Rusi: Në Këshillin e Lartë Gjyqësor do të raportojë.

Naureda Llagami: Po mirë pra do e themi. Ku është kjo bashkëlidhur këtij vendimi, ku është kjo?

Ilir Rusi: Formati është. Ja ku është “Shtojca”.

Naureda Llagami: Ku e kemi formatin?

Po mirë pra, ku raporton pra, se këtë s’e kemi thënë.

Ilir Rusi: Do ta shtojmë.

Naureda Llagami: E kemi të shkruar apo s’po e shoh unë?

Ilir Rusi: Do e themi.

Naureda Llagami: Po mirë pra, propozohet nga relatori “Këshilli raporton çdo 3 muaj.

Ilir Rusi: Këshilli i Gjykatës raporton në Këshillin e Lartë Gjyqësor çdo 3 muaj për ecurinë e shqyrtimit të çështjeve të prapambetura sipas listave të grupçështjeve sipas formatit të raportimit bashkëlidhur këtij vendimi.”, dhe është kjo “Shtojca”, “Shtojca 1” e saj.

Naureda Llagami: Atëherë, për t’i thënë shkurtimisht kush janë gjërat që ne kemi rënë dakord këtu meqë i kam mbajtur shënim.

Fillojmë njëherë që tek preambula, jo grupi i punës, por të jenë të tre emrat e

anëtarëve propozues, si kemi mbajtur standardin me gjithë aktet e tjera, se keni vënë grupin e punës. Në mbledhje plenare nuk propozon grupi i punës, propozojnë tre anëtarë.

E dyta, midis variantit 1, në fund të fjalisë së parë do përdorim termin “listën e grupçështjeve të caktuara në përjashtim të radhës sipas vendimit të Këshillit të Gjykatës”, pra ramë dakord që të jetë lista e grupçështjeve.

Kalojmë, tek pika e 2 nuk kishim diskutime por pranuar variantin e parë.

Kalojmë, tek pika 3 kemi hequr pjesën “Ky vendim i njoftohet menjëherë Këshillit të Lartë Gjyqësor, i cili shprehet brenda 3 ditëve për pranimin ose jo”. Kemi hequr këtë fjali.

Klodian Kurushi: Vetëm se tek “grupçështjet e caktuara”, mos duhet të shtohet “lista e grupçështjeve të caktuara me përjashtim të rregullit”?

Domethënë, pika 3: Pas pikës 1 shtohet pika 1/1...

Naureda Llagami: Atëherë, kemi ecur me variantin e parë. Pika 2.

Pika 3 ikën.

Kalojmë tek pjesa e nenit 2. Tek neni 2 kemi thënë që, kemi hequr shprehjen “vetëm” dhe kemi shtuar paralelisht “... ose në përputhje me listën e grupçështjeve të caktuara në përjashtim të radhës sipas vendimit të Këshillit të Gjykatës”. Pra kemi hequr fjalën “vetëm” dhe shtuar “... ose në përputhje me...”, tek neni 1, në togfjalëshin e fjalisë së parë.

Po them ato që kemi ndryshuar Ilir, jo për ato që neve nuk kemi folur, sepse duhet zbardhja t’i mbajë shënim.

Kalojmë tek neni 1, varianti i dytë. Këtu kemi vetëm me grupçështje, që ne e kemi ezauruar se është lista.

Tek neni 2, fjalia e parë ndryshon si vijon: Gjyqtari relator cakton datën në përputhje me kalendarin e tij të shqyrtimit të çështjeve duke mbajtur parasysh kërkesat për përshpejtim - se është për - për përshpejtim ose listën e grupçështjeve të miratuara nga Këshilli i Gjykatës”.

Pastaj kemi thënë që neni 3.1 do të riformulohet si më poshtë dhe aty do reflektosh edhe pikën “e” dhe të gjithë shtesat dhe gjithë çfarë ke. Neni 3.1 do të riformulohet si më poshtë, dhe do vini të gjithë ndryshimet që keni.

Kalojmë tek pika 7 këtu, ku themi që neni 3.1 shtohet një fjali me këtë përmbajtje. Për fjalinë jemi dakord, vetëm do heqim fjalinë e fundit. Në fakt nuk shtohet një fjali por shtohen dy fjali në fakt. Kështu që do themi shtohet paragrafi, ose do themi një fjali, meqë mbeti një fjali, dhe heqim një të fundit.

Neni 3, hiqet vetëm tek pika 4, hiqet vetëm “...dhe për dijeni edhe Këshillit të Lartë Gjyqësor.”, dhe tek pika 5 shtohet “Këshilli i Gjykatës raporton çdo tre muaj në KLGJ për ecurinë e shqyrtimit të çështjeve të prapambetura.”. Këto janë gjërat që dakordësuam. “..sipas listës së grupçështjeve”. (Sipas shtojcës).

Atëherë, jemi dakord me këto ndryshime të teknikës legjislative?

Kalojmë në votim në tërësi projekt-aktin me gjithë këto ndryshimet që bëmë. Nga ana e administratës, përpara se të publikohen, t’i vihet në dispozicion të gjithë anëtarëve, të dakordësohemi ku kemi ndryshuar; akti final dhe më pas ta publikojmë. Dakord?

Miratojmë projekt-aktin me gjithë ndryshimet?

Ilir Rusi: Dakord.

Irena Plaku: Pro.

Gentiana Muçaj: Dakord.

Ridvan Hado: Dakord.

Alban Toro: Dakord.

Fatmira Luli: Dakord.

Markelian Koça: Dakord.

Yllka Rupa: Pro.

Emona Muçi: Dakord.

Klodian Kurushi: Dakord.

Naureda Llagami: Dakord.

Atëherë Këshilli miratoi projektvendimin për disa shtesa dhe ndryshime në vendimin e Këshillit të Lartë Gjyqësor nr. 78, datë 30.05.2019 “Për kalendarin e

shqyrtimit të çështjeve në gjykatën e apelit”, sipas propozimit të grupit të punës, pra tre anëtarëve, por edhe ndryshimeve që patëm në diskutimin me kolegët.

* * *

(Pika 4 e rendit të ditës)

Për Këshillin e Lartë Gjyqësor



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____.____.2024

PROCESVERBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR

(Mbledhje e realizuar me video konferencë)

(Mbajtur, më 09.05.2024)

Pika 5 e rendit të ditës me objekt: Shqyrtimi i projektvendimit “Për pranimin/refuzimin e kërkesës së gjyqtarit z. {...} “Për përjashtimin e relatores znj. Irena Plaku nga procedura e vlerësimit etik dhe profesional, për periudhën 2017-2019”” (Çështje që ishte për trajtim në mbledhjen e datës 02.05.2024, si dhe në mbledhjen e datës 07.05.2024).¹

Drejton mbledhjen Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, zonja Naureda Llagami.

Mbledhja u zhvillua në sallën e mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 11:10 dhe mbaroi në orën 13:48.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

1. *Naureda Llagami* (kryetare)
2. *Ilir Rusi* (zëvendëskryetar)
3. *Klodian Kurushi* (anëtar)
4. *Fatmira Luli* (anëtare)
5. *Irena Plaku* (anëtare)
6. *Gentiana Muçaj* (anëtare)
7. *Ridvan Hado* (anëtar)

¹ Kjo çështje ishte parashikuar të trajtohej e 6-ta sipas rendit të ditës.

- | | |
|--------------------------|------------------|
| 8. <i>Alban Toro</i> | <i>(anëtar)</i> |
| 9. <i>Markelian Koça</i> | <i>(anëtar)</i> |
| 10. <i>Yllka Rupa</i> | <i>(anëtare)</i> |
| 11. <i>Emona Muçi</i> | <i>(anëtare)</i> |

Morën pjesë gjithashtu nëpërmjet platformës dhe në sallë:

1. *Rudin Baqli, Sekretar i Përgjithshëm.*
2. *Blerta Ngucaj, Drejtore e Departamentit të Shërbimeve Juridike dhe Marrëdhënieve me Jashtë.*
3. *Luan Dibra, Rezarta Taushani, Gentiana Agushi, Këshilltarë pranë Komisioneve të Përhershme në Këshill.*
4. *Denisa Varfi dhe Entela Dobi, përfaqësuese të Ministrisë së Drejtësisë.*
5. *Arturo Valdes dhe Arben Lila, përfaqësues të Projektit EU4Justice. (në sallë)*
6. *Olta Lolo dhe Valbona Bala, përfaqësuese të EWMI/INL. (në sallë)*
7. *Sidorela Driçi, AIS Instituti Shqiptar i Shkencës (prezent në një pjesë të mbledhjes).*
8. *Staf nga administrata e KLGJ-së.*

RENDI I DITËS:

5. Shqyrtimi i projektvendimit “Për pranimin/refuzimin e kërkesës së gjyqtarit z. {...} “Për përjashtimin e relatores znj. Irena Plaku nga procedura e vlerësimit etik dhe profesional, për periudhën 2017-2019”” (Çështje që ishte për trajtim në mbledhjen e datës 02.05.2024, si dhe në mbledhjen e datës 07.05.2024).

Naureda Llagami: Kalojmë në projekt-aktet e fundit.

Kalojmë tek dy aktet.

Kemi dy situata që i janë vendosur Këshillit. Situata e parë, kemi kërkesën e zotit {...}, i cili ka kërkuar për të përjashtuar relatorin dhe të gjithë anëtarët e Komisionit.

Atëherë, fillojmë me kërkesën e z. {...}, i cili ka kërkuar përjashtimin e anëtares

znj. Irena Plaku nga procedurat e vlerësimit etik dhe profesional.

Argumenti që zoti {...} i thotë Këshillit të Lartë Gjyqësor ka të bëjë me faktin si më poshtë:

Kërkesën për përjashtim z. {...} e ka paraqitur duke marrë shkas nga vlerësimi që i është bërë nga Këshilli për vitin 2022, në të cilën ka qenë relatore znj. Plaku. Konkretisht gjyqtari parashtron në kërkesën e tij, me e-mail-in e datës 14.09.2022, se është njoftuar nëpërmjet postës elektronike, për fillimin e procedurës së vlerësimit etik dhe profesional për periudhën e vlerësimit 2017-2019, për vlerësuesit e përzgjedhur në bazë të shortit: Relatore znj. Irena Plaku dhe nëpunëse përgjegjëse për vlerësim znj. Esmerilda Habili. Zoti {...} ka konfirmuar marrjen dijeni, duke deklaruar se është dakord me vlerësuesit dhe nuk ka bërë kërkesë për përjashtimin e tyre. Kjo procedurë vlerësimi është akoma në proces dhe nuk ka përfunduar.

Pas këtij momenti, me e-mail-in e datës 15.06.2023, ndaj gjyqtarit ka filluar procedura e detyruar e përshpejtuar e vlerësimit etik dhe profesional për vitin 2022. Nëpërmjet procedurës së shortit, edhe për këtë vlerësim është përzgjedhur znj. Irena Plaku, dhe nëpunëse përgjegjëse znj. Erlanda Agaj, për të cilat z. {...} në kohë ka shprehur dakordësinë e tij.

Gjatë zhvillimit të procedurës së vlerësimit për vitin 2022, me e-mail-in e datës 17.01.2024, gjyqtarit i janë komunikuar projekt-aktet përkatëse për vlerësimin e tij për vitin 2022. Gjithashtu, i është bërë me dije e drejta për të aksesuar dosjen e vlerësimit dhe për ta kundërshtuar atë me shkrim brenda 2 javëve nga data e marrjes së njoftimit. Me e-mail-in e datës 22.01.2024, ka konfirmuar marrjen e njoftimit, si dhe ka bërë me dije se e ka të nevojshme aksesimin e dosjes së vlerësimit dhe në vijim të paraqes kundërshtime dhe prova të reja. Gjithashtu, ka kërkuar të dëgjohet gjatë seancës dëgjimore në KLGJ. Me tej gjyqtari shprehet se, pavarësisht se ka kërkuar të aksesojë dosjen e vlerësimit, nga ana e relatores nuk i është kthyer përgjigje. Kjo gjë e ka detyruar që në respektim të afatit të caktuar, të paraqes kundërshtimet e tij, së bashku me provat shkresore.

Kërkesën për përjashtimin e relatores Irena Plaku nga procedura e vlerësimit për periudhën 2017-2019, e bazon në këto pretendime:

i. Mosdhënia e aksesit në dosjen e vlerësimit sipas kërkesës së tij. Gjyqtari bën me dije se nëse do të kishte patur mundësi aksesimi të dosjes edhe kundërshtimet e tij do të ishin më të plotë, duke paraqitur një tablo më të qartë të situatës dhe me një pritshmëri ndryshe vlerësimi në përfundim të këtij procesi. Ky moment për z. {...} vë në dyshim paanësinë e relatores znj. Irena Plaku.

ii. Momenti tjetër në të cilën z. {...} vë në dyshim paanësinë e relatores është gjatë prezantimit të projektvlerësimit të tij për periudhën 2022. Ai pretendon se relatorja për treguesin 4.C.a “Pjesëmarrja e gjyqtarit në programet e formimit vazhdues të Shkollës së Magjistraturës dhe në trajnime të tjera profesionale”, nuk mori në konsideratë provën shkresore nr. {...} prot., datë 23.01.2024 të Shkollës së Magjistraturës të depozituar prej tij, dhe si rrjedhojë nuk ia ndryshoi pikëzimin për këtë tregues.

iii. Ndërsa, momenti tjetër i referohet kur ka dëgjuar regjistrimin audio të seancës për vlerësimin e tij, për vitin 2022, duke shprehur se nga dëgjimi i këtij regjistrimi kuptohet tendenca e relatores për të mos pranuar shkresën zyrtare të dërguar nga Shkolla e Magjistraturës, ndërkohë që ajo, referuar dispozitave ligjore në fuqi përbën akt me fuqi të plotë provuese. Kjo gjë sipas z. {...} ka penguar edhe Këshillin për të vlerësuar edhe treguesit e tjerë të vlerësimit, për të cilat ai kishte paraqitur kundërshtimet.

Sa më sipër, z. {...} shprehet se shkak i përjashtimit të relatores nga procedura e vlerësimit të tij për periudhën 2017-2019 ka lindur në datë 04.03.2024, në të cilën ai ka dëgjuar regjistrimin audio të seancës plenare të Këshillit dhe për këtë arsye, kërkesën për përjashtim po e paraqet në këtë moment procedural.

Kërkesa për përjashtim i është komunikuar edhe relatores e cila me shkresën nr. {...} prot., ka shprehur qëndrimin se nuk ka shkaqe për përjashtim nga procedura e vlerësimit të gjyqtarit.

Nga ana tjetër, bëjmë me dije se gjyqtari e ka kundërshtuar edhe gjyqësisht raportin e tij por që Gjykata Administrative e Apelit, me vendimin nr. 34, datë 16.04.2024 ka vendosur rrëzimin e kësaj kërkesë padie.

Pra kjo është situata e shkaqeve që pretendon gjyqtari për përjashtimin e relatores.
Kemi ndonjë diskutim?

Kemi ndonjë propozim?

Atëherë jeni për pranimin? Çfarë do hedhim në propozim? Sepse kjo është një situatë të cilën duhet ta vlerësojë Këshilli.

Po, z. Kurushi!

Klodian Kurushi: Faleminderit zonja Kryetare!

Përtej kërkesave që ka parashtruar magjistrati duke kërkuar përjashtimin e relatores nga vijimi i procesit të vlerësimit etik dhe profesional, unë mendoj që këto janë kërkesa të cilat nuk lidhen me shkaqet dhe arsyet ligjore të përjashtimit të një anëtari të Këshillit të Lartë Gjyqësor, si për shkaqe papajtueshmërie, për shkaqe arsye serioze njëanshmërie që mund të mbajnë në procesin e vlerësimit, si për shkaqe që lidhen me ligjin “Për konfliktin e interesave”, kështu që në këto kushte mendoj se kjo kërkesë nuk është e mbështetur si në ligjin “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, ashtu edhe në ligjin “Për konfliktin e interesave”. Ndodhur në këto kushte unë propozoj që kjo kërkesë të rrëzohet. Faleminderit!

Naureda Llagami: Atëherë, hedhim në votim propozimin e z. Kurushi. Nuk merr pjesë në votim relatorja (bëhet fjalë për znj. Plaku).

Ilir Rusi: Dakord.

Gentiana Muçaj: Dakord.

Ridvan Hado: Dakord.

Alban Toro: Dakord.

Fatmira Luli: Dakord.

Markelian Koça: Dakord.

Yllka Rupa: Pro.

Emona Muçi: Dakord.

Klodian Kurushi: Dakord.

Naureda Llagami: Dakord.

Atëherë Këshilli vendosi:

1. Refuzimin e kërkesës nr. {...} prot., datë 05.03.2024 të gjyqtarit z. {...}, për përjashtimin e anëtares relatores znj. Irena Plaku nga procedura e vlerësimit etik dhe profesional, për periudhën 2017-2019.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në faqen zyrtare.

* * *

(Pika 5 e rendit të ditës)

Për Këshillin e Lartë Gjyqësor



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____.____.2024

PROCESVERBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR

(Mbledhje e realizuar me video konferencë)

(Mbajtur, më 09.05.2024)

Pika 6 e rendit të ditës me objekt: Shqyrtimi i projektvendimit “Për pranimin/refuzimin e kërkesës së z. {...} “Për përjashtimin e relatorit dhe të anëtarëve të Komisionit të Zhvillimit të Karrierës, nga procedurat për të cilat ai ka kandiduar për lëvizje paralele në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë” (Çështje që ishte për trajtim në mbledhjen e datës 02.05.2024, si dhe në mbledhjen e datës 07.05.2024)²

Drejton mbledhjen Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, zonja Naureda Llagami.

Mbledhja u zhvillua në sallën e mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 11:10 dhe mbaroi në orën 13:48.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

- | | |
|----------------------------------|---------------------------------|
| <i>1. Naureda Llagami</i> | <i>(kryetare)</i> |
| <i>2. Ilir Rusi</i> | <i>(zëvendëskryetar)</i> |
| <i>3. Klodian Kurushi</i> | <i>(anëtar)</i> |
| <i>4. Fatmira Luli</i> | <i>(anëtare)</i> |
| <i>5. Irena Plaku</i> | <i>(anëtare)</i> |
| <i>6. Gentiana Muçaj</i> | <i>(anëtare)</i> |

² Kjo çështje ishte parashikuar të trajtohej e 5-ta sipas rendit të ditës.

- | | |
|--------------------------|------------------|
| 7. Ridvan Hado | (anëtar) |
| 8. Alban Toro | (anëtar) |
| 9. Markelian Koça | (anëtar) |
| 10. Yllka Rupa | (anëtare) |
| 11. Emona Muçi | (anëtare) |

Morën pjesë gjithashtu nëpërmjet platformës dhe në sallë:

- 1. Rudin Baqli, Sekretar i Përgjithshëm.**
- 2. Blerta Ngucaj, Drejtore e Departamentit të Shërbimeve Juridike dhe Marrëdhënieve me Jashtë.**
- 3. Luan Dibra, Rezarta Taushani, Gentiana Agushi, Këshilltarë pranë Komisioneve të Përhershme në Këshill.**
- 4. Denisa Varfi dhe Entela Dobi, përfaqësuese të Ministrisë së Drejtësisë.**
- 5. Arturo Valdes dhe Arben Lila, përfaqësues të Projektit EU4Justice. (në sallë)**
- 6. Olta Lolo dhe Valbona Bala, përfaqësuese të EWMI/INL. (në sallë)**
- 7. Sidorela Driçi, AIS Instituti Shqiptar i Shkencës (prezent në një pjesë të mbledhjes).**
- 8. Staf nga administrata e KLGJ-së.**

RENDI I DITËS:

6. Shqyrtimi i projektvendimit “Për pranimin/refuzimin e kërkesës së z. {...} “Për përjashtimin e relatorit dhe të anëtarëve të Komisionit të Zhvillimit të Karrierës, nga procedurat për të cilat ai ka kandiduar për lëvizje paralele në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë” (Çështje që ishte për trajtim në mbledhjen e datës 02.05.2024, si dhe në mbledhjen e datës 07.05.2024)

Naureda Llagami: Kalojmë në pjesën e dytë. Edhe këtu kemi të bëjmë me një kërkesë tjetër. Edhe kjo kërkesë shkurtimisht tashmë.

Pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor ka ardhur në rrugë elektronike, më datë

29.04.2024, kërkesa e z. {...} në të cilën kërkohet përjashtimi i relatorit z. Alban Toro dhe dy anëtarëve të Komisionit të Karrierës z. Klodian Kurushi dhe z. Markelian Koça, nga shqyrtimi procedurave të përzgjedhjes për lëvizje paralele në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë për pozicionet e shpallura nr. 256, 257 dhe 258, datë 24.05.2023 të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Me kërkesën e tij, z. {...} ka ngritur pretendime për njëanshmëri të relatorit dhe anëtarëve të Komisionit të Zhvillimit të Karrierës (KZHK) duke qenë se kanë një marrëdhënie varësie të drejtpërdrejtë “epror vartës” me kandidaten znj. {...}, e cila kandidon në të njëjtat procedura për lëvizjen paralele pranë Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë.

Referuar procesverbalit audio të mbledhjes plenare të datës 25.04.2024 të Këshillit të Lartë Gjyqësor, Komisioni i Zhvillimit të Karrierës me relator z. Alban Toro, kanë propozuar kualifikimin e kandidates në procedurat konkrete të lëvizjes paralele. Kërkuesi i referohet edhe rastit të propozimit të anëtarëve të Komisionit të Zhvillimit të Karrierës, me relator sërish z. Toro, që kandidatja z. {...} të transferohej në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë për shkak të suprimimit të pozicionit të saj në Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Fier. Ky propozim është rrëzuar në mbledhjen plenare të Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe në përfundim znj. {...} është emëruar pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë.

Për shkak të rrethanave të mësipërme, si dhe marrëdhënies së varësisë mes anëtarëve të KZHK-së dhe kandidates znj. {...}, kërkuesi ka ngritur pretendime për njëanshmëri me palët në procedurat administrative në shqyrtim.

Gjithashtu, për të shmangur konfliktin e interesit për anëtarët e këtij komisioni, në referim të ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar, ai kërkon zëvendësimin e tyre me anëtarët zëvendësues, të cilët nuk kanë marrëdhënie varësie direkte me znj. {...}.

Kërkesa e tij për përjashtimin e relatorit dhe anëtarëve, e ka mbështetur në nenin 68, pika 3, neni 72 të ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, në Kodin e Procedurave Administrative, ligjin “Për parandalimin e konfliktit

të interesave në ushtrimin e funksioneve publike”, si dhe në vendimin e Këshillit të Lartë Gjyqësor “Për miratimin e rregullave të vlerësimit etik e profesional të gjyqtarëve të komanduar në Këshillin e Lartë Gjyqësor”.

Atëherë, këto janë pak a shumë shkaqet që ka ngritur.

Po, zoti Toro!

Alban Toro: Pra gjithmonë duke u mbështetur në të njëjtat dispozita ligjore të Kodit të Procedurës Civile të cilat rregullojnë përjashtimin, më takon të jap një opinion në lidhje me çfarë është parashtruar nga kandidati dhe më pas do largohem.

Natyrisht vlerësoj jashtëzakonisht që kandidati {...} pasi përfundimisht la barrën e komunikimeve informale bërë me Këshillin e Lartë Gjyqësor nëpërmjet mjeteve arkaike të letrave të hapura dhe iu nënshtrua procedurës duke investuar këtë institucion me këtë kërkesë për përjashtim.

Natyrisht, shikoj që shkak i tij lidhet me marrëdhënien epror-vartës, me një nga kandidatët, e cila është edhe njëkohësisht, bën pjesë tek sektori ligjor i Këshillit të Lartë Gjyqësor, dhe pikërisht ky raport sipas tij përbën konflikt interesi. Ndërkohë, proceduralisht, të njëjtin shkak, i cili besoj që duhet të ishte krijuar dhe më parë, duhet ta kishte bërë që në datën 04.03.2024 kur është njohur me një nga anëtarët në momentin e verifikimit. Ka munguar një kërkesë e tillë. Në opinionin tim, duke qenë që ky shkak duhet të kishte krijuar edhe në atë moment, kërkesa ka rënë në dekadencë.

Gjithsesi i nënshtrohemi, marrim edhe rastin hipotetik sikur nuk jemi në dekadencë, por duhet ta interpretojmë nga pikëpamja e themelit të çështjes dhe të cilin ai e ka mbështetur tek konflikti i interesit, i rregulluar nga ligji specifik. Sipas nenit 3, pikës 1 të këtij ligji, konflikti i interesit përfaqëson gjendjen e konfliktit midis detyrës publike dhe interesave private të një zyrtari, në të cilat ai ka interesa private të drejtpërdrejta ose të tërthorta që ndikojnë, mund të ndikojnë ose duket sikur ndikojnë në kryerjen në mënyrë të padrejtë të detyrave dhe përgjegjësive të tyre publike.

Neni 5 i të njëjtit ligj “Interesat private të zyrtarit” e përkufizon interesin që përputhen, përmbajnë apo bazohen, apo burojnë nga: a) të drejta dhe detyrime pasurore të

çdo lloj natyre; b) çdo marrëdhënie tjetër juridiko-civile; c) dhurata, premtime, favore, trajtime preferenciale; ç) negocime të mundshme për punësim në të ardhmen nga ana e zyrtarit gjatë ushtrimit të funksionit apo negocime për çdo lloj forme tjetër marrëdhëniesh me interesa privat për zyrtarin, pas lënies së detyrës, të kryer nga ai gjatë ushtrimit të detyrës; d) angazhime në veprimtari private me qëllim fitimi ose çdo lloj veprimtarie, që krijojnë të ardhura, si dhe angazhime në organizata fitimprurëse dhe jofitimprurëse, sindikata ose organizata profesionale, politike, shtetërore dhe çdo organizatë tjetër; dh) marrëdhënie: i) familjare apo të bashkëjetesës; ii) të komunitetit; iii) etnike; iv) fetare; v) të njohura të miqësisë apo të armiqësisë; e) angazhime të mëparshme, nga të cilat kanë buruar ose burojnë interesa të përmendur në shkronjat e mësipërme të këtij neni.

Ndërsa në nenin 3, paragrafi 11, i ligjit 9367 përkufizohet përkufizimi i personit të lidhur me një zyrtar, sipas të cilit personi i lidhur me një zyrtar është çdo person fizik ose juridik, i cili rezulton të ketë pasur ose të ketë lidhje interesi, pasurore ose vetjake jo pasurore, sipas nenit 5 të këtij ligji, me zyrtarin.

Pra dispozitat e ligjit 9367/2005 statusin e personit të lidhur të zyrtarit e mbart ai që është person fizik ose juridik që ka lidhje pasurore apo interesi me zyrtarin duke iu referuar për përcaktimin e konceptit të interesit të parashikimit që bën neni 5 i ligjit 9367/2005, të cilën e cituam edhe më lart.

Pra duke parë gamën e dispozitave që rregullojnë konfliktin e interesit, dispozitat të cilat rregullon ligji 115, që rregullon për përjashtimin apo për heqjen dorë, verifikoj që nuk ka asnjë shkak të bazuar për t'u pranuar një kërkim i tillë. Akoma më abstrakt apo absurd bëhet kur konflikti shikohet tek tre anëtarët aktual të komisionit por nuk shikohet tek zëvendësat e tij të cilët me ç'duket nuk paskan të njëjtën lidhje varësie në piramidën drejtuese të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Kjo e bën akoma më absurde kërkimin dhe normalisht, të paktën, konform ligjit, teorikisht nuk duhet pranuar.

Faleminderit!

Naureda Llagami: Ky është qëndrimi i z. Toro lidhur me kërkesën e bërë.

Po, zoti Kurushi!

Klodian Kurushi: Faleminderit zonja Kryetare!

Duhet të bëj prezent qëndrimin tim në lidhje me kërkesën e bërë nga z. {...} në këtë rast. Ai kërkesën për përjashtimin e tre anëtarëve të Komisionit të Zhvillimit të Karrierës e ka mbështetur në disa dispozita ligjore dhe akte nënligjore.

E para, është vendimi nr. 159, datë 05.04.2023 “Për miratimin e rregullave të vlerësimit etik dhe profesional të gjyqtarëve të komanduar në Këshillin e Lartë Gjyqësor”, ku thotë që ne kemi marrëdhënie varësie, pra anëtarët e Komisionit kanë marrëdhënie varësie me këshilltaren që në këtë rast është në garë. Por në këtë pikë ai harron të vazhdojë më tej, meqenëse kemi raport varësie pse duhet të bëjmë vlerësimin ne? Pse e bëjmë vlerësimin?

Pra ne i kemi miratuar rregullat. Ne si anëtarë të Komisionit e bëjmë vlerësimin. A kemi neve rast apo shkak për papajtueshmëri interesash apo për konflikt interesi? Ja që rregullorja thotë jo. Të gjithë anëtarët e kanë votuar dhe thotë në këtë rast ne e bëjmë vlerësimin e kandidatës që është në garë (ne si anëtarë të komisionit), por nuk kemi probleme në këtë rast. Paskemi probleme se kemi një raport varësie.

E dyta, zotëria ngre si shkak arsye serioze njëanshmërie, referuar nenit 30 të Kodit të Procedurave Administrative. Tani, në këtë pikë jam një çik i prekur dhe dua t’ia përmend zotërisë, por për transparencë edhe të gjithë kolegëve dhe atyre personave të interesuar që na dëgjojnë sot në mbledhje, dua të rendis disa fakte të cilat përtej këtij raporti, mua personalisht nuk më ndikojnë në procesin tim të vendimmarrjes duke përfshirë edhe kandidaten që është në garë. Ju kujtoj, jeni dëshmitarë, ju kujtoj rastin e hapjes së procedurave të lëvizjes paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë Administrative Tiranë, me vendimet 256, 257, 258, datë 24.05.2023 dhe në këtë listë, ndërmjet të tjerave ishte edhe kandidatja për të cilën sot gjyqtari ka kërkuar përjashtimin tonë, pra zonja {...}. Më tej, pra pasi është bërë publike kjo listë dhe gjyqtarja {...} vazhdonte të punonte në Komisionin e Zhvillimit të Karrierës si Këshilltare, më datë 21.06.2023 sjell në kujtesë të Këshillit, kemi diskutuar çështje që lidhen me verifikimin e kritereve formale për kandidatët për gjyqtarë të cilët kishin shprehur interesin për lëvizje paralele, konkretisht,

do i kërkoj ndjesë gjyqtarit {...} që i përmend emrin për verifikimin e kriterëve formale, në atë mbledhje të Këshillit, unë, si relator i kësaj kërkesë, kam mbajtur qëndrimin që z. {...}, duke përfshirë edhe të gjithë gjyqtarët e tjerë që kishin bërë kërkesa për lëvizje paralele, nuk plotësonin kriterin formal të 5 viteve punë si gjyqtar, pra një nga kriteret formale ishte brenda 5 viteve që gjyqtari të kishte 1 vit përvojë në fushën përkatëse specifike të së drejtës, dhe këtu përfshihej edhe znj. {...}, {...} më falni, që kishte konkurruar, dhe në këtë situatë unë mbajta një qëndrim, duke mos treguar në atë rast arsye serioze njëanshmërie sepse kjo vendimmarrje ishte shumë e rëndësishme dhe mendimi im në atë kohë ishte që si z. {...} ashtu edhe të gjithë gjyqtarët e tjerë që nuk plotësonin afatin e eksperiencës së përgjithshme në detyrë prej 5 vitesh, nuk plotësonin kriterin formal, një nga kriteret formale, dhe në këtë pikë unë ngrita propozimin që ai duhet të skualifikohej, duke mbajtur atë qëndrim, nëse Këshilli do të ma mbështeste, atëherë, pa dyshim që edhe zonja {...} e cila kishte bërë kërkesën për lëvizje paralele, duhet të skualifikohej, megjithëse ishte këshilltare në Komisionin e Zhvillimit të Karrierës.

Tani në këtë pikë, unë e deklaroj që nëse do të kisha arsye serioze njëanshmërie, mund të dakordësohesha shumë mirë me vendimin e të gjithë kolegëve. Nuk u dakordësova. Mbajta një qëndrim dhe ishte qëndrim ligjor. Kështu e mendova në atë kohë. Kjo ishte pjesa e arsyeve serioze që i referohet nenit 30 të Kodit të Procedurave Administrative. Pra po të kisha arsye të tilla, do isha dakordësuar që në atë kohë.

Tani, në lidhje me pikën tjetër të diskutimit që i referohet ligjit “Për konfliktin e interesit”, nuk e kuptoj se çfarë interesash private paskam unë me zonjën {...}? Se duhet të na i ngrejë ky zotëria, është edhe gjyqtar dhe të na thotë cilat janë interesat private konkrete që unë paskam me zonjën {...}, që më bëjnë mua pengesë për të vijuar më tej procedurën. Apo duhet ta provoj unë tani që kam ndonjë interes privat? Këtë ai nuk e ka trajtuar dhe unë nuk kam se çfarë të shprehem në lidhje me këtë pikën.

Dhe e fundit fare. Dhe e fundit fare, për të sqaruar kolegët edhe një herë. Jemi në procesin e renditjes së kandidatëve. Renditja e kandidatëve, që ta dinë të gjithë, ata që na dëgjojnë se ne këtu e dimë, nuk bëhet mbi bazën e vlerësimit që bën Këshilli. Renditjen e

ka përcaktuar Shkolla e Magjistraturës sepse të gjithë këta kandidatët që janë në garë në procesin e lëvizjes paralele nuk kanë mundësi për shkak të përvojës më pak se trevjeçare në momentin që kanë paraqitur kërkesën, nuk ka mundësi t'i bëhet një vlerësim nga Këshilli. Nëse do të plotësohej ky afat kohor dhe t'i bëhej një vlerësim, absolutisht që unë mendoj që znj. {...} ishte në konflikt interesi referuar ligjit “Për konfliktin e interesit”. Por renditjen nuk e bëjmë ne, se e ka përcaktuar ligji, renditjen e bën Shkolla e Magjistraturës dhe jam i bindur që këta, të gjithë kandidatët e kanë bërë renditjen e tyre sepse kanë marrë listat e shkollës, sikundër janë bërë renditjet edhe për kolegët e tyre në lëvizjet paralele që ne i kemi bërë gjatë vitit që shkoi, me listat e Shkollës së Magjistraturës. Kështu që në këtë pikë, as vullnet dhe as diskrecion nuk shfaq në rastin e renditjes, për të qenë në konflikt interesi.

Ndodhur në këto kushte, megjithëse unë nuk do të marrë pjesë në votim, unë e shpreh këtë qëndrimin tim, që kërkesa e paraqitur nga zotëria, nuk gjen, sipas mendimit tim, përputhje ligjore për t'u pranuar. Faleminderit!

Markelian Koça: Unë nuk po zgjatem si dy kolegët e mi. Po të kisha vlerësuar që do të ishin kushtet, do të kisha paraqitur dorëheqjen. Kështu që, le ta vlerësojë Këshilli këtë pozicion. Faleminderit!

Naureda Llagami: Po!

Gentiana Muçaj: Që në fillimet e kësaj, që në fillimin e hapjes së kësaj procedure, unë kam shprehur mendimin tim që të gjithë anëtarët e Këshillit janë në konflikt interesi, për aq kohë sa kandidatja {...} vazhdon të jetë e komanduar pranë këtij Këshilli dhe nuk është ndërprerë ky komandim.

Fatmira Luli: Atëherë, të them edhe unë dy fjalë?

Naureda Llagami: Ne jemi këtu tek vlerësimi i kërkesës së atyre, ne nuk jemi në

qëndrimet... Po mirë pra, kur të vijë puna tek vlerësimi i votimit të atyre, po. Komisioni kishte tjetër qëndrim, që jepte çështjen që pse e mendonte ndryshe. Ndërkohë ne këtu jemi tek pjesa e vlerësimit të kërkesës për përshpejtim, më fal, kërkesën për përjashtim, shkak i kërkesës dhe kërkesa për përjashtimin. Jemi tek kjo pjesë, a ka shkak kërkesa për përjashtim.

Gentiana Muçaj: Dhe unë po them që unë nuk mund të dalë, se anëtarët e Komisionit janë anëtarë të Këshillit dhe janë pjesë e Këshillit, dhe unë nuk mund të dalë tej qëndrimit tim që them që të gjithë anëtarët e Këshillit janë në konflikt interesi.

Fatmira Luli: Të them unë dy fjalë?

Unë e konsideroj kërkesën jo vetëm të pabazuar në ligj, por edhe abuzive, në kuptimin që nuk ka parashtruar - ai e di mirë se është gjyqtar vetë dhe gjykon të tilla kërkesa çdo ditë – nuk ka formuluar dhe artikuluar asnjë shkak të ligjshëm pse ai e kërkon këtë kërkesë për përjashtim. Jo vetëm kaq, por në arsyetimin e tij me të cilën përpiqet të lidhë dispozitat me njëra-tjetrën, thotë që Komisioni i Zhvillimit të Karrierës është struktura përgjegjëse që bën vlerësimin etik-profesional të kësaj kandidateje, fakt i cili nuk është i vërtetë. Kësaj kandidateje nuk i bëhet asnjë vlerësim etik dhe profesional dhe ne kemi pas praktikë dhe vendimmarrje më parë për rastet kur kemi pas punonjëse të cilët o duhet t'i kontrollojmë pasurinë, ose duhet t'i bënim vlerësim etiko-profesional, vendime që krijojnë pasoja. Vendimet thjesht rutinë për të cilët Këshilli nuk mban asnjë vlerësim por vetëm rendit ose nuk krijojnë asnjë pasojë, nuk janë konsideruar vendime që impaktojnë dhe krijojnë konflikt interesi. Në këto kushte kërkoj/gjykoj që kërkesa duhet rrëzuar.

Naureda Llagami: Atëherë, në çështjen e votimit. Në fakt unë kam shumë dilemë tek pjesa e votimit, nëse e ka Këshilli kuorumin për të votuar çështje të tjera, a duhet të përjashtohemi të gjithë? Se kjo është në fakt pjesë shumë problematike sepse nesër-pasnesër një gjyqtar mund të kërkojë të gjithë Këshillin për ta përjashtuar, me argumente

që hanë diskutim dhe interpretim nga të gjithë ne. Dhe çfarë i bie që Këshilli të dali të gjithë nga shqyrtimi i kërkesës sepse unë mund të kem konflikt interesi apo mund të kem mendime të tjera?! Kështu që kjo është një çështje që në fakt ne e kemi folur dhe duhet të jetë pjesë e shqyrtimit në fakt e metodologjisë që ka Këshilli për vlerësimin e kërkesave për përjashtim, sepse në fakt ligji thotë kërkesa për përjashtim shqyrtohet nga Këshilli. Por Këshilli mund t'ia delegojë këtë në fakt për më shumë funksionalitet një organi tjetër që e delegon Këshilli, qoftë një Komisioni, sepse nuk mund të investohet i gjithë Këshilli, të gjithë ne, për të diskutuar një kërkesë për përjashtimin e tij. Ndoshta duhet parë këtë në kuptimin e një rregullimi më të posaçëm se si duhet të veprojmë në këto kërkesa. Edhe nuk është pjesë e mbledhjes, pra nuk është te çështjet që renditet tek mbledhja. Kjo mund të jetë edhe një çështje që nuk kemi pse ne investohemi të 11-të këtu. Megjithatë, në rastin konkret, për sa kohë s'kemi një rregullim më të posaçëm, kështu që do vijojmë siç kemi vijuar edhe në praktikën tjetër, ku investohet gjithë mbledhja dhe po në praktikën e kaluar, personat për të cilët kërkohet përjashtimi, pra kolegët, ato nuk marrin pjesë në votim. Kështu që, me këtë logjikë, z. Kurushi, z. Toro dhe z. Koça nuk do marrin pjesë në votim. Ndërkohë që zonja Plaku, nuk merr pjesë, sepse ka shkaqe të tjera të papajtueshmërisë për të qenë në këtë lloj votimi.

Atëherë, po hedhim propozimin mbi refuzimin e kërkesës së gjyqtarit z. {...} për përjashtimin e anëtarëve të Komisionit të Zhvillimit të Karrierës. Jemi dakord?

Ilir Rusi: Dakord.

Gentiana Muçaj: Kundër.

Ridvan Hado: Dakord.

Fatmira Luli: Dakord.

Yllka Rupa: Pro.

Emona Muçi: Dakord.

Naureda Llagami: Dakord.

Atëherë Këshilli vendosi:

Refuzimin e kërkesës së gjyqtarit z. {...}, për përjashtimin e anëtarëve të Komisionit të Zhvillimit të Karrierës nga procedurat e përzgjedhjes së lëvizjes paralele në

Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë për pozicionet e lira të shpallura me vendimet nr. 256, 257 dhe 258, datë 24.05.2023 të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Njoftimi i këtij vendimi i bëhet z. {...}.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

* * *

(Pika 6 e rendit të ditës)

Për Këshillin e Lartë Gjyqësor



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____.____.2024

PROCESVERBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR

(Mbledhje e realizuar me video konferencë)

(Mbajtur, më 09.05.2024)

Pika 7 e rendit të ditës me objekt: Shqyrtimi i projektvendimit “Për caktimin e gjyqtarit për gjykimin e çështjes gjyqësore të veçantë në gjykatë tjetër, të ndryshme nga ajo ku ushtron funksionet në mënyrë të përhershme”, i përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës (relator z. Klodian Kurushi).

Drejton mbledhjen Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, zonja Naureda Llagami.

Mbledhja u zhvillua në sallën e mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 11:10 dhe mbaroi në orën 13:48.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

1. ***Naureda Llagami*** (kryetare)
2. ***Ilir Rusi*** (zëvendëskryetar)
3. ***Klodian Kurushi*** (anëtar)
4. ***Fatmira Luli*** (anëtare)
5. ***Irena Plaku*** (anëtare)
6. ***Gentiana Muçaj*** (anëtare)
7. ***Ridvan Hado*** (anëtar)
8. ***Alban Toro*** (anëtar)

9. *Markelian Koça* (anëtar)
10. *Yllka Rupa* (anëtare)
11. *Emona Muçi* (anëtare)

Morën pjesë gjithashtu nëpërmjet platformës dhe në sallë:

1. *Rudin Baqli, Sekretar i Përgjithshëm.*
2. *Blerta Ngucaj, Drejtore e Departamentit të Shërbimeve Juridike dhe Marrëdhënieve me Jasthë.*
3. *Luan Dibra, Rezarta Taushani, Gentiana Agushi, Maela Alicanaj Këshilltarë pranë Komisioneve të Përhershme në Këshill.*
4. *Denisa Varfi dhe Entela Dobi, përfaqësuese të Ministrisë së Drejtësisë.*
5. *Arturo Valdes dhe Arben Lila, përfaqësues të Projektit EU4Justice. (në sallë)*
6. *Olta Lolo dhe Valbona Bala, përfaqësuese të EWMI/INL. (në sallë)*
8. *Staf nga administrata e KLGJ-së.*

RENDI I DITËS:

7. Shqyrtimi i projektvendimit “Për caktimin e gjyqtarit për gjykimin e çështjes gjyqësore të veçantë në gjykatë tjetër, të ndryshme nga ajo ku ushtron funksionet në mënyrë të përhershme”, i përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës (relator z. Klodian Kurushi).

Naureda Llagami: Atëherë, po me mirëkuptimin tuaj, dua për shkak të urgjencës që ka, një delegim pra një caktim gjyqtari në një gjykatë ne nevojë, do doja që të shqyrtohet nga mbledhja e Këshillit edhe kjo, pavarësisht se nuk e kishim të përfshirë në rendin e ditës apo të shtyrë nga mbledhjet e tjera, por për shkak të urgjencës unë do propozoja nëse kam nga ju mirëkuptimin që të shqyrtohet tani.

Relatimi do bëhet nga zoti Kurushi.

Të lutem administrata të marri masa për lidhjen me hedhjen e shortit.

Klodian Kurushi: Faleminderit zonja Kryetare!

Deri më datë 08.05.2024, pranë KLGJ-së, janë regjistruar për trajtim kërkesa për caktim gjyqtari për gjykimin e çështjes gjyqësore të veçantë, kërkesë e paraqitur nga Zëvendëskryetari i Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, sipas të dhënave të më poshtme. Bëhet fjalë për një çështje penale, me objekt të akuzës Nenet 283/1, 28/4, 333/a/1, 334 të Kodit Penal. Numri i gjyqtarëve që kërkohet të caktohet është 1. Numri i kërkesës 1718 dhe numri i çështjes 78.

Kërkohet caktimi i 1(një) gjyqtari për plotësimin e trupit gjykues për gjykimin e çështjes penale të themelit me të pandehur {...}, {...} etj. Trupi gjykues përbëhet nga gjyqtarët {...} dhe {...}.

Kanë pengesë gjyqtarët {...}, {...} dhe {...}, pasi kanë kryer veprime paraprake për procedimin penal në ngarkim të të pandehurve {...}, {...} etj.

Trupi gjykues i përbërë nga {...}, {...} dhe {...} kanë dhënë vendimin, në ngarkim të të pandehurit në procedim të lidhur {...}.

Trupi gjykues i përbërë nga gjyqtarët: {...}, {...} dhe {...} kanë dhënë vendimin, në ngarkim të të pandehurit në procedim të lidhur shtetasja {...}.

Zbatimi i mekanizmit të skemës së delegimit të gjyqtarit dhe zbatimi i mekanizmit të transferimit të përkohshëm të gjyqtarit bëhet i pamundur për t'u aplikuar në rastin konkret, ndodhur në këto kushte në si Komision propozojmë të vihet në zbatim mekanizmi i caktimit të gjyqtarit për gjykimin e një çështjeje gjyqësore të veçantë, në një gjykatë tjetër, të ndryshme nga ajo ku ushtron funksionin në mënyrë të përhershme. Kërkesa mbështetet në paragrafin X/2 të Vendimit të KLGJ-së si edhe referuar më tej përcaktimeve të shkronjës “c”, pika 5, Kreu IV, të këtij Vendimi, KZHK propozon:

Gjykata nga duhet të përzgjidhen gjyqtarët që do të caktohen për gjykimin e 1 (një) çështjeje gjyqësore të veçantë, të jenë gjykatat e shkallës së parë të juridiksionit të përgjithshëm.

Gjyqtarët për gjykimin e 1 (një) çështjeje gjyqësore të veçantë të përzgjidhen me short, ndërmjet atyre të cilët kanë të paktën shtatë vjet përvojë në ushtrimin e profesionit, nga të cilat të paktën pesë vjet si gjyqtar për çështjet penale, si dhe kanë kaluar me sukses

procesin e rivlerësimit kalimtar sipas Ligjit nr. 84/2016.

Numri i gjyqtarëve që duhet të caktohen për gjykimin e 1 (një) çështjeje gjyqësore të veçanta, të jetë 1 (një).

Në opsionin e pranimit të propozimit si më lart, për hapat e shortit që duhet të ndiqen, Komisioni i Zhvillimit të Karrierës propozon:

Për 1 (një) çështje, për të cilën kërkohet 1 gjyqtar, të përzgjidhet me short 1 i tillë, ndërmjet gjyqtarëve të gjykatave të shkallës së parë të juridiksionit të përgjithshëm që plotësojnë kriteret e mësipërme.

Përrjashtimet nga shorti

Referuar paragrafit VIII të Vendimit të KLGJ-së të cituar më lart, Komisioni i Zhvillimit të Karrierës propozon:

Nga shorti të përjashtohen gjyqtarët e shortuar së fundmi dhe që kanë ngarkesë në GJKKKO: znj. {...}, znj. {...}, znj. {...}, znj. {...}, z. {...}, z. {...}, Si edhe ish-anëtarët e KLGJ-së sipas asaj çfarë kemi diskutuar: znj. {...} dhe z. {...}.

Gjyqtarët e tjerë janë të integruar në listën që i bashkëlidhet këtij propozimi. Faleminderit!

Naureda Llagami: Dakord me propozimet.

Tani të vijohet me hedhjen e shortit.

Nga shorti elektronik përzgjidhet (referuar tabelës në relacion):

Për kërkesën 1718, gjyqtare e përzgjedhur znj. Esmeralda Xhili.

Naureda Llagami: Me kaq po e mbyllim mbledhjen për sot.

Faleminderit për bashkëpunimin.

* * *

(Pika 7 e rendit të ditës)

Për Këshillin e Lartë Gjyqësor